

VËLLIMI X XIII /TETOR - DHJETOR/ 2023

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2023**

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

- Nr.1021, Datë 13.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË KUOTAVE TË SHOQËRISË SVEVIND NORDIC AB NGA SHOQËRIA STATKRAFT SVERIGE AB.”
- Nr.1022, Datë 13.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE JERUSALEM HOLDING S.A., CENTRAL EOLICA BAQUEIRAO I S.A. DHE CENTRAL EOLICA BAQUEIRAO II S.A. NGA SHOQËRIA STATKRAFT ENERGIAS RENOVAVEIS S.A.”
- Nr.1023, Datë 13.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NJORDR OFFSHORE WIND AB NGA SHOQËRIA STATKRAFT OFFSHORE WIND AS.”
- Nr.1024, Datë 13.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRISË PARQUE EÓLICO LITUECHE SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”.
- Nr.1025, Datë 13.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT NË REZIDENCAT E BANIMIT TË QARKUT TË TIRANËS NË TREGUN E AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT”.
- Nr.1026, Datë 26.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO - ALBANIA BRANCH SHPK”
- Nr.1027, Datë 26.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË BIZNESIT TARGET TË SHOQËRISË ARTEMIS OOD NGA SHOQËRIA SMURFIT KAPPA BULGARIA EOOD.”
- Nr.1028, Datë 26.10.2023**Error! Bookmark not defined.**
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ABO WIND WP FLECHTDORF GMBH & CO. KG NGA SK WIND GMBH & CO. KG.”.
- Nr.1029 Datë 03.11.2023 32
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË 41% TË KUOTAVE TË SHOQËRISË ITALIA TRASPORTO AEREO S.P.A. NGA SHOQËRIA DEUTSCHE LUFTHANSA AKTIENGESELLSCHAFT”

- Nr.1030, Datë 03.11.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË PARQUE EÓLICO LITUECHE SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A”
- Nr.1031, Datë 03.11.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI MIRATIMIN E LOGOS SË RE TË AUTORITETIT TË KONKURENCËS”
- Nr.1032, Datë 14.11.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE STATKRAFT WINDENERGIE GMBH & CO.KG DHE EOLIENNES SUROIT SNC NGA SHOQËRITË STATKRAFT GERMANY GMBH, STATKRAFT HOLDING WIND & SOLAR DEUTSCHLAND GMBH DHE STATKRAFT RENOUVELABLES SASU”
- Nr.1033, Datë 14.11.2023**4Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË ROUTE MOBILE LIMITED NGA SHOQËRIA PROXIMUS OPAL”.
- Nr.1034, Datë 05.12.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM NGA SHOQËRIA CSIC LONGJIANG GH GAS TURBINE CO., LTD MBI ASETET E BIZNESIT TË TURBINAVE ME GAZ TË MAN ENERGY SOLUTIONS SE”
- Nr.1035, Datë 05.12.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË VOLVO BUSINESS SERVICES INTERNATIONAL AB DHE RENAULT S.A.S”
- Nr.1036, Datë 12.12.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË DONI FRUITS SHPK NGA SHOQËRIA GJONAJ GROUP HOLDINGS SHPK DHE Z. EJUP AHMETI”
- Nr.1037, Datë 12.12.2023**Error! Bookmark not defined.**
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË LEVI RALLY CENTER OY NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT, NËPËRMJET SHOQËRISË PORSCHE INVESTMENTS MANAGEMENT S.A.”.
- Nr.1038, Datë 22.12.2023 58
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË KAPITALIT AKSIONAR TË SIMON & SCHUSTER (UK) LTD DHE SIMON & SCHUSTER, INC. NGA CENTURY DE BUYER LLC DHE CENTURY UK BUYER LTD”.
- Nr.1039, Datë 22.12.2023 60
 “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË WESTROCK COMPANY NGA SHOQËRIA SMURFIT KAPPA GROUP PLC”.

Nr.1040, Datë 22.12.2023.....	Error! Bookmark not defined.
“MBI MIRATIMIN E UDHËZUESIT “MBI PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR ZBULIMIN E INFORMACIONIT NË BAZAT E TË DHËNAVE, GJATË PROCEDURAVE HETIMORE DHE TË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE TË PARASHIKUARA NË LIGJIN NR. 9121, DATË 28.07.2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”.	
Nr.1041, Datë 26.12.2023.....	Error! Bookmark not defined.
“PËR ZGJEDHJEN E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”.	
Nr.1042, Datë 26.12.2023.....	68
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN “UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË” SHA.	
Nr.1043, Datë 29.12.2023.....	74
“MBI MIRATIMIN E “MANUALIT TË PROCEDURAVE PËR SJELLJET ANTIKONKURRUESE””.	
Nr.1044, Datë 29.12.2023	76
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË FIER THERMOELECTRIC SHA NGA SHOQËRITË DEPA COMMERCIAL S.A., GEK TERNA S.A. DHE GENER 2 SHPK”.	
Nr.1045, Datë 29.12.2023	82
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE ERZENI SHPK, GJIROFARMA SHA, ADG SHPK (LUFRA), SHAKA BOBOSHTICË SHPK NË TREGUN E PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË NËNPRODUKTEVE TË QUMËSHTIT(DJATH DHE GJALPË)”.	

VENDIM

Nr. 1021, Datë 13. 10. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË KUOTAVE TË SHOQËRISË SVEVIND NORDIC AB NGA SHOQËRIA STATKRAFT SVERIGE AB.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Svevind Nordic AB nga shoqëria Statkraft Sverige AB.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Svevind Nordic AB nga shoqëria Statkraft Sverige AB,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi mbi përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Svevind Nordic AB nga shoqëria Statkraft Sverige AB.

Referuar “Marrëveshje shitblerje kuotash”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Blerësi: Statkraft Sverige AB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë. Blerësi është i angazhuar në gjenerimin dhe furnizimin e energjisë elektrike, më së shumti përmes hidrocentraleve.

Statkraft Sverige AB është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë. Statkraft AS është plotësisht në pronësi të shtetit norvegjez. Statkraft AS është shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupi

Statkraft, i cili është prodhuesi më i madh i Norvegjisë dhe prodhuesi i tretë më i madh i rajonit Nordik. Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, është një shoqëri aksionare me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shitësi: Svevind AB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Suedez. Svevind AB planifikon, zhvillon, projektton, shet dhe operon energjinë e erës, si dhe projekte të hidrogjenit të gjelbër etj.

Target: Svevind Nordic AB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Suedez, me aksionar shoqërinë Svevind AB. Svevind Nordic AB është zhvilluese e projekteve të energjisë nga era në Suedi. Në datën e nënshkrimit, shoqëria ka blerë biznesin e zhvillimit të energjisë së erës në tokë të shitësit, siç përcaktohet në “Marrëveshjen e Transferimit të Biznesit”.

Target zotëron 100% filialin Hästliden Nordic Vind AB.

Hästliden Nordic Vind AB (Filiali) Ndërmarrja e re, është një shoqëri me qëllime të veçanta e krijuar për të zotëruar të gjitha të drejtat dhe asetet e projektit në lidhje me projektin e fermës së erës Hästliden Greenfield, i vendosur në grupin Markbygden të fermës së erës në komunën Piteå, Suedi.

Shoqëria target nuk ka prezencë dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Statkraft Sverige AB (blerësi) dhe shoqërisë Svevind AB (shitësi) është lidhur “Marrëveshje shitblerje kuotash”, e nënshkruar datë 28 shtator 2023.

Referuar kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, shitësi dëshiron të shesë 100% të aksioneve në shoqëri të blerësi dhe blerësi dëshiron të blejë aksionet nga shitësi, në secilin rast sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Shoqëria Svevind Nordic AB, zotëron të gjitha aksionet e filialit të saj Hästliden Nordic Vind AB.

Aksionet shiten të lira nga të gjitha barrët dhe së bashku me të gjitha përfitimet dhe të drejtat që lidhen me to.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Svevind Nordic AB nga shoqëria Statkraft Sverige AB.

Statkraft Sverige AB zotërohet 100% nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëria Target Svevind Nordic AB është një shoqëri suedeze, aktive në zhvillimin e projekteve të energjisë nga era në Suedi. Shoqëria Target nuk është prezent dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

Blerësi dhe Target janë aktive në tregun e prodhimit të energjisë së rinovueshme në Suedi.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Svevind Nordic AB nga shoqëria Statkraft Sverige AB.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1022, Datë 13. 10. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE JERUSALEM HOLDING S.A., CENTRAL EOLICA BAQUEIRAO I S.A. DHE CENTRAL EOLICA BAQUEIRAO II S.A. NGA SHOQËRIA STATKRAFT ENERGIAS RENOVAVEIS S.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi transaksionin e blerjes së aksioneve të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A.

Referuar “Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Energias Renovaveis S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Brazilit, me objekt aktiviteti: i) pjesëmarrjen në shoqëri të tjera në fushat e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme, transmetimit të energjisë elektrike; ii) ofrimin e shërbimeve këshillimore, konsulente, administruese, menaxhuese dhe mbikëqyrëse, në fushat e tyre të veprimtarisë dhe iii) zbatimin, financimin dhe funksionimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme, me fokus kryesor prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe gjithashtu duke përfshirë projektet e erës, diellit dhe biomasës.

Statkraft Energias Renovaveis S.A. është pjesë e Grupit Statkraft, i cili është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: EDP Renovaveis Brasil S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Brazilit. EDP Renovaveis Brasil S.A. është një shoqëri holding për institucione jofinanciare.

Shoqëritë Target:

Target 1: Jerusalem Holding S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Brazilit, me objekt aktiviteti: shoqëri holding për institucione jofinanciare.

Jerusalem Holding S.A. ka në zotërim gjashtë filiale: Central Eolica Jerusalem I S.A., Central Eolica Jerusalem II S.A., Central Eolica Jerusalem III S.A., Central Eolica Jerusalem IV S.A., Central Eolica Jerusalem V S.A., Central Eolica Jerusalem VI S.A.

Target 2: Central Eolica Baqueirao I S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Brazilit, me objekt aktiviteti: prodhimin e energjisë elektrike.

Target 3: Central Eolica Baqueirao II S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Brazilit, me objekt aktiviteti: prodhimin e energjisë elektrike.

Shoqëritë Target nuk janë prezent dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Statkraft Energias Renovaveis S.A. (blerësi) dhe shoqërisë EDP Renovaveis Brasil S.A. (shitësi) është lidhur “Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve”, e nënshkruar datë 29 gusht 2023.

Referuar kësaj marrëveshje, shitësi është pronari ligjor dhe përfitues i aksioneve, që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të secilës prej shoqërive target. Që nga data e hyrjes në fuqi, Jerusalem Holding S.A. (nëpërmjet pronësisë së shoqërive operuese në Jeruzalem), zotëron dhe operon në mënyrë indirekte impiantet të erës të vendosura në shtetin e Brazilit (Impiantet e erës në Jeruzalem), Central Eolica Baqueirao I S.A. zotëron dhe operon një impiant të erës të vendosur në shtetin e Brazilit (Impiantet e erës së Baqueirao I) dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. zotëron dhe operon një impiant të erës të vendosur në shtetin e Brazilit (Impiantet e erës së Baqueirao II).

Në përputhje me kushtet paraprake dhe dispozitat e kësaj marrëveshjeje, shitësi pranon të shesë dhe t'i transferojë blerësit titullin e plotë ligjor të aksioneve, me efekt nga përfundimi dhe blerësi pranon të blejë nga shitësi aksionet, së bashku me të gjitha të drejtat që i bashkëngjiten atyre.

Transaksioni i propozuar, konsiston në përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A., i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, treg përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A.

Statkraft Energias Renovaveis S.A. zotërohet 81.3% nga Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft. Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë Target, Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. janë shoqëri braziliane, aktive në gjenerimin dhe furnizimin e energjisë përmes burimeve të erës.

Shoqëritë Target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Jerusalem Holding S.A., Central Eolica Baqueirao I S.A. dhe Central Eolica Baqueirao II S.A. nga shoqëria Statkraft Energias Renovaveis S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1023, Datë 13. 10. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NJORDR OFFSHORE WIND AB NGA SHOQËRIA STATKRAFT OFFSHORE WIND AS.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit, nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitjen e aksioneve”, e nënshkruar në datë 06.10.2023 palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Offshore Wind AS është një shoqëri private, me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. Nëpërmjet shoqërive Offshore, grupi Statkraft po zhvillon disa projekte të prodhimit të energjisë prej erës në det të hapur, në Detin e Veriut, i fokusuar në Norvegji dhe Irlandë.

Statkraft Offshore Wind AS është shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë.

Statkraft AS është shoqëria mëmë e disa filialeve të Statkraft Group dhe zotërohet tërësisht nga Statkraft FS.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më datë 25.07.2018, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA është një shoqëri aksionare e themeluar më datë 17.12.2008, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisë prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit, përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Njordr AS është një shoqëri norvegjeze, e organizuar dhe e regjistruar sipas ligjeve të Norvegjisë. Shoqëria ushtron aktivitet në prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në tokë dhe në det të hapur, e fokusuar në vendet nordike. Shoqëria Njordr AS zotëron 57.6% të aksioneve tek shoqëria Target.

Shitësi 2: Vindkraft Värmland AB është një shoqëri suedeze, e organizuar dhe e regjistruar sipas ligjeve të Suedisë. Shoqëria ushtron aktivitet në prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në tokë dhe në det të hapur, e fokusuar në vendet nordike.

Shoqëria Njordr AS zotëron 36.7% të aksioneve tek shoqëria Target.

Shitësi 3: Kovall AB është një shoqëri suedeze, e organizuar dhe e regjistruar sipas legjislacionit të Suedisë. Shoqëria ushtron aktivitet në prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet projekteve të fermave të erës.

Shoqëria Kovall AB zotëron 3.9 % të aksioneve tek shoqëria Target.

Shitësi 4: Ribera AB është një shoqëri suedeze, e organizuar dhe e regjistruar sipas legjislacionit të Suedisë.

Shoqëria Ribera AB zotëron 1.8 % të aksioneve tek shoqëria Target.

Shoqëria Target: Njordr Offshore Wind AB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë.

Shoqëria Target zotëron filialet: Beta Njordr Offshore Wind AB dhe Njordr Offshore Elnät AB shoqëri të regjistruara në Suedi.

Shoqëria Target, nëpërmjet filialeve të saj është zhvillues i projekteve të energjisë së erës në Suedi. Shoqëria Target dhe filialet e saj nuk kanë prezencë ligjore dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Referuar “Marrëveshje për shitjen e aksioneve”, të nënshkruar më datë 6 tetor 2023, rezulton se mes shoqërive Njordr AS, Vindkraft Värmland AB, Kovall AB, Ribera AB (shitësit) dhe shoqërisë Statkraft Offshore Wind AS (blerësi) është lidhur një marrëveshje me objekt shitblerjen nga palët të 100% të aksioneve të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB (target).

Referuar kushteve paraprake të Blerësit dhe Shitësve, pika 8 e marrëveshjes, transaksioni i njoftuar duhet të marrë miratimin e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës. Transaksioni nuk është objekt shqyrtimi në asnjë juridiksion tjetër dhe palët synojnë implementimin e tij brenda datës 17 tetor 2023.

Pas transaksionit, shoqëria target dhe dy filialet e saj, do të zotërohen 100% nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, nëpërmjet fermave të erës në det të hapur, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS.

Statkraft Offshore Wind AS zotërohet 100% nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet burimeve solare dhe të ujit.

Shoqëria target Njordr Offshore Wind AB dhe filialet e saj ushtrojnë aktivitet në fushën e prodhimit të energjisë se rinovueshme, energjisë së erës dhe nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Njordr Offshore Wind AB nga shoqëria Statkraft Offshore Wind AS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 1024, Datë 13. 10. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECNOFER S.P.A. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. DHE ERSEL MANAGEMENT S.G.R S.P.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Management S.G.R S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Management S.G.R S.p.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Management S.G.R S.p.A.

Referuar “Kontratë Shitblerje Aksionesh”, e nënshkruar më datë 04 gusht 2023, palët në transaksion janë:

Pala Blerëse:

Blerësi 1: Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas

legjislacionit italian, regjistruar në Regjistrin e Kompanive në Milano-Monza-Brianza-Lodi, me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimit të administrimit të aktiveve kolektive të kursimeve, i cili kryhet nëpërmjet administrimit të organeve alternative të investimeve kolektive të kursimit dhe rreziqeve përkatëse, si dhe administrimi dhe tregtimi i tyre, dhënia e shërbimeve të menaxhimit të portofoleve, ofrimi i shërbimeve ndihmëse, si dhe kryerja e veprimtarive përkatëse dhe instrumentale etj. Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A, për shkak të delegimit të menaxhimit, vepron në emër dhe për llogari të Eurizon Capital S.G.R S.p.A.

Eurizon Capital S.G.R S.p.A. është një shoqëri aksionare me një aksionar të vetëm, e themeluar sipas legjislacionit italian, e cila merret me investime, me tjetërsime dhe me negocime të drejtave që kanë të bëjnë me titujt, lëshimin dhe asgjësimin e certifikatave të pjesëmarrjes etj.

Eurizon Capital S.G.R S.p.A. është shoqëria kontrolluese e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Intesa SanPaolo Group. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit.

Blerësi 2: Ersel Management S.G.R S.p.A. është një shoqëri aksionare, me një aksionar, e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti: menaxhimin e fondeve të ndërsjella të harmonizuara italiane, që diferencohen nga politika e menaxhimit, e tregut dhe e sigurimeve, dy fonde pasurish të paluajtshme dhe një fond mbështetës.

Ersel Management S.G.R S.p.A. është një filial i Grupit Ersel, aktiv në menaxhimin e asetëve. Ersel Management S.G.R S.p.A. zotërohet plotësisht nga Ersel S.p.A, shoqëria mëmë e Grupit Bankar Ersel.

Grupi Ersel nuk është aktiv dhe as gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Pala Shitëse: Executive S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive në Mantova. Shoqëria Executive S.p.A. zotërohet 50% nga Marco Ascari dhe 50% nga Carlo Ascari.

Z. Marco Ascari & Z. Carlo Ascari janë persona fizikë, shtetas italian.

Shoqëria Target: Tecnofer S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së hekurudhave, të tilla si: shërbime kontrolli vegjetacioni hekurudhe; shërbime për pastrimin e tunelit për hekurudhat dhe trenat nëntokësorë; shërbimet për zbardhjen e shinave; shërbime konsultuese teknike hekurudhore; prodhimin e makinerive dhe pajisjeve për mirëmbajtjen e hekurudhës etj.

Tecnofer S.p.A. nuk është aktive dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 4 gusht 2023, shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. (blerësi 1), Ersel Management S.G.R S.p.A. (blerësi 2), Executive S.p.A. (shitësi) dhe Z. Marco Ascari & Z. Carlo Ascari kanë nënshkruar “Kontratë Shitblerje Aksionesh”. Në po këtë datë, shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A., Ersel Management S.G.R S.p.A. dhe z. Carlo Ascari kanë nënshkruar “Marrëveshje Investimi”. Ndërmjet shoqërisë HoldCo Iter dhe Ersel Management S.G.R S.p.A. është nënshkruar “Marrëveshja e Aksionarëve”, në datë 04 gusht 2023.

Transaksioni do të realizohet në disa faza, do të krijohen disa shoqëri ndërmjetëse, të cilat do të ndihmojnë në blerjen e kapitalit të shoqërisë target Tecnofer.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target Tecnofer S.p.A. do të zotërohet rreth 90% nga shoqëria JV (nëpërmjet Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A dhe Ersel Management S.G.R S.p.A.) dhe rreth

10% nga shoqëria Executive S.p.A.

Bordi i Drejtorëve i Tecnofer S.p.A. do të përbëhet nga 6 drejtorë, nga të cilët 3 drejtorë do të emërohen nga HoldCo Iter, 2 drejtorë do të emërohen nga Ersel Management S.G.R S.p.A. dhe 1 drejtor do të emërohet nga Executive S.p.A. Vendimet e Bordit të Drejtorëve do të miratohen në mënyrë të vlefshme me praninë dhe votën e favorshme të shumicës së drejtorëve në detyrë me kusht që të paktën 1 drejtor i emëruar nga HoldCo Iter dhe të paktën 1 drejtor i emëruar nga Ersel Management S.G.R S.p.A. të jenë të pranishëm dhe të japin votën e favorshme. Vendimet e Bordit të Drejtorëve në lidhje me transaksionet tregtare me palët e lidhura të shoqërisë target Tecnofer S.p.A. (të cilat nuk janë kryer në kushtet e tregut), do të miratohen në mënyrë të vlefshme, vetëm nëse ekziston edhe vota e favorshme e drejtorit të emëruar nga shoqëria Executive S.p.A.

Referuar marrëveshjeve të nënshkruara, transaksioni i njoftuar përbën një përfitim kontrolli mbi të drejtën e vetos. Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit midis ndërmarrjeve”, pika 3.2 është përcaktuar se: “Kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur nuk ka barazi ndërmjet dy ndërmarrjeve mëmë për sa i përket votave ose në përfaqësimin në organet vendimmarrëse. Ky është rasti kur aksionaret në pakicë kanë të drejta shtesë, të cilat u lejojnë atyre të marrin vendime vetoje, të cilat janë thelbësore për sjelljen strategjike tregtare të sipërmarrjes së përbashkët/joint venture. Të drejtat e vetos në vetvete mund të ushtrohen nëpërmjet mjeteve të një kuorumi të caktuar, të kërkuar për vendimet që merren në mbledhjen e aksionareve ose nga bordet e drejtorëve në masën që ndërmarrjet mëmë janë përfaqësuar në këtë bord.”

Duke qenë se shoqëria Executive S.p.A. nuk ka të drejtën për të vendosur lidhur me çështje strategjike të shoqërisë target Tecnofer S.p.A., atëherë rrjedhimisht Executive S.p.A. nuk do të ushtrojë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë target Tecnofer S.p.A.

Transaksioni i propozuar, konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Management S.G.R S.p.A., transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së hekurudhës, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Asset Management S.G.R S.p.A.

Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. operon, me anë të një delegimi menaxhimi, në emër të Eurizon, si shoqëri e menaxhimit të fondit italian të investimeve alternative të mbyllura të rezervuara (AIF) dhe e AIF pa rezervë me fund të mbyllur (Eurizon Iter Funds).

Eurizon, si një shoqëri nënholding e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Grupit Intesa Sanpaolo dhe një filial i kontrolluar drejtpërdrejtë nga Intesa Sanpaolo S.p.A., është i pranishëm në Shqipëri përmes shoqërisë Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, aktiv në tregun e shërbimeve bankare.

Ersel është një filial i i Grupit Ersel, aktiv në menaxhimin e asetëve. Grupi Ersel nuk ka filial dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Tecnofer S.p.A. është një shoqëri italiane, e cila ofron shërbime të mirëmbajtjes së hekurudhave dhe prodhimit të makinerive dhe pajisjeve për mirëmbajtjen e tyre. Tecnofer S.p.A. nuk është prezente dhe

nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Tecnofer S.p.A. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Ersel Asset Management S.G.R S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1025, Datë 13. 10. 2023

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT NË REZIDENCAT E BANIMIT TË QARKUT TË TIRANËS NË TREGUN E AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datë 13.10.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, mbi monitorimin e tregut të ofrimit të shërbimit të internetit pranë komplekseve të pallateve në Tiranë,

VËREN SE:

1. Nisur nga disa ankesa të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbi problematikat në zgjedhjen e ofrimit të shërbimit të internetit pranë disa komplekseve të pallateve Tiranë, bazuar në nenin 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në zbatim të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 33, datë 23.8.2023 të Autoritetit të Konkurrencës “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e tregut të ofrimit të shërbimit të internetit pranë komplekseve të pallateve në Tiranë”, grupi i punës realizoi monitorimin pranë disa komplekseve të pallateve në Tiranë.
2. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimeve të kryera pranë komplekseve të pallateve në Tiranë, rezultoi se, në kompleksin Square 21, pavarësisht deklaratës së ndërmarrjes së administrimit se banorët dhe bizneset janë të lirë të zgjedhin ofrues interneti sipas dëshirës së tyre, sipas deklaratës së një biznesi pranë këtij kompleksi, u tha se prej 3 vitesh janë të lidhur me ndërmarrjen Tring SHPK dhe nuk mund ta ndryshojnë atë, pasi në këtë kompleks interneti ofrohet

vetëm nga ndërmarrja Tring SHPK. Ndërsa në kompleksin Star Construction, për shkak të infrastrukturës së ndërtuesit, sipas ndërmarrjes së administrimit kishte mundësi vetëm për një ofrues interneti të operonte në hapësirën e kompleksit, duke e bërë kështu të pamundur zgjedhjen e një ofruesi tjetër për këtë shërbim në kompleks.

3. Ndërmarrjet e administrimit e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zbatim të Ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit". Referuar nenit 19, të këtij ligji, Kryesia, në emër dhe për llogari të asamblesë, mund të lidhë kontratë për administrimin e bashkëpronësisë me: (a) një shoqëri administrimi; (b) një administrator, person fizik, i cili mund të jetë njëri prej bashkëpronarëve ose një person i jashtëm. Çdo person, fizik apo juridik, privat, që ka për objekt veprimtarie administrimin e ndërtesave, regjistrohet në librin e administruesve, pranë bashkisë, komunës, në juridiksionin e së cilës do ta ushtrojë këtë veprimtari.
4. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se në tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës, ka problematika dhe mund të ketë elementë të abuzimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet e administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës, e cila mund të përbëjë shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të nenit 9, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit.
- II. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2020 deri në 13.10.2023
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1026, Datë 26. 10. 2023

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E
PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE
RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO - ALBANIA BRANCH SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, mbi “Raportin e hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK”,

VËREN SE:

I. Procedura Ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023) ka depozituar Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.BO-Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023”.
2. Në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 66 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 31, pika 3 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet Vendimit nr. 555/2023 ka vendosur:

- a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.
 - b) T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë Komisionin e Prokurimit Publik në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.
3. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet Vendimit nr. 555/2023, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet LI.BO-Albania Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, vihet re se:
- Operatori Raimondo G.P SHPK dhe operatori LI.BO-Albania Branch SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
 - Gjithashtu sipas të dhënave në ekstrakt, të cilat njoftohen vullnetarisht rezulton se adresa e emailit dhe numri i telefonit fiks është i njëjtë për të dyja ndërmarrjet.
 - Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;
 - Të dy operatorët nuk kanë plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik” dhe Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ka elementë të një sjelljeje antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës.
5. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me Vendimin nr. 1000, datë 17.07.2023, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, për periudhën kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023.
6. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë: (i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca.
7. Në zbatim të Vendimit nr. 1000, datë 17.07.2023 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 373/3, datë 17.07.2023 “Autorizim inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu

inspektimet e nevojshme pranë adresave të deklaruara në QKB të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK. Me paraqitjen e inspektorëve në adresën e përbashkët të dy subjekteve, u konstatua se në këtë adresë operonte ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK.

8. Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.
9. Ndërmarrja Raimondo G.P SHPK në datë 31.07.2023, dhe ndërmarrja Li.Bo - Albania Branch SHPK në datë 29.08.2023, janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku janë pyetur nga Sekretariati për çështjen objekt hetimi.
10. Gjatë inspektimit dhe nga takimet e realizuara pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka rezultuar se ndërmarrja Li.Bo në Itali është furnitor i ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK.
11. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Albanian Gas Service Company SHA.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

12. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
13. Procedurat e prokurimeve publike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike .
14. Nga informacioni i marrë gjatë procedurës hetimore nga APP me shkresën nr. 373/8 prot., datë 31.07.2023, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimeve publike të autoritetit kontraktor Albanian Gas Service Company SHA.
15. Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet shkresës nr. 373 prot., datë 06.07.2023, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ për procedurën e prokurimit me nr. Ref. 66587-04-19-2023, dhe objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA.
16. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu i prokurimit publik i pajisjeve instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG).

17. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
18. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve

19. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD¹ “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit² të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD, “Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluara në Oferta në Prokurimet Publike”.
20. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin, si më poshtë:
- | | |
|--------------------------|------------------------------|
| - Li.Bo - Albania Branch | 3.592.000 lekë, skualifikuar |
| - Raimondo G.P | 3.640.000 lekë, kualifikuar |
| - TrakMar | 3.640.000 lekë, kualifikuar |
| - Alen-Co | 3.801.680 lekë, kualifikuar |
| - Ligus | 4.100.000 lekë, kualifikuar |
| - Trinity Trade Company | 4.198.000 lekë, kualifikuar |
21. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Albanian Gas Services Company SHA në rolin e autoritetit kontraktues, nga APP dhe KPP si edhe dokumentacioni i gjetur gjatë procedurave të inspektimit në Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në zyrën e ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK.
22. Ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK. (i) Ndërmarrja Raimondo G.P ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen Prime Advisory Albania SHPK, ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj; (ii) Për ndërmarrjen Li.Bo - Albania Branch SHPK, Prime Advisory Albania SHPK ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se Li.Bo - Albania Branch SHPK, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë Prime Advisory Albania SHPK.
23. Ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK, gjatë periudhës kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023, kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:

¹ <http://www.oecd.org/competition/cartels/fightingbidrigginginpublicprocurement.htm>

² <http://www.caa.gov.al/file/publikimet/brochure.pdf>

- i. Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Kualifikuar ndërmarrja Raimondo G.P SHPK.
 - ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA.
24. Ndërmarrja Li.Bo Albania Branch SHPK, renditur e para, është skualifikuar nga procedura e prokurimit me me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, për arsye si më poshtë vijon:
- Ka dorëzuar në SPE kopje të pa noterizuara dhe pa vulë apostile të faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane LI.BO SRL.
 - E njëjta gjë konstatohet edhe në Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015.
 - Nuk plotëson kriterin për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.
25. Nga verifikimi Dokumentave Standarde të Tenderit, të dërguara nga ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, në procedurën e prokurimit me REF: 66587-04-19-2023, rezultojnë se kanë disa elementë të ngjashëm, konkretisht:
- Lista e çmimeve të artikujve;
 - Formulari i Ofertës;
 - Dy ekstrakte QKB për secilën ndërmarrje, të cilat janë printuar të dyja në të njëjtën datë por në orare të ndryshme;
 - Tabelat që ndërmarrjet kanë përdorur për të ofertuar produktet janë të ngjashme, tabela e ndërmarrjes Li.Bo – Albania Branch SHPK përkatësisht e titulluar “CIPS & DCVG table for tender” dhe tabela e ndërmarrjes Raimondo G.P. SHPK e titulluar “CIPS & DCVG table for tender”;
 - Për noterizimin e Certifikatës ISO, të dy ndërmarrjet kanë vajtur tek e njëjta notere, Belinda V. Celaj, por në data të ndryshme.
26. Sa më sipër, vihet re se ndërmarrjet mund të përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord që njëri nga konkurrentët të paraqesë një ofertë e cila përmban terma specifike të cilat janë të papranueshme nga autoriteti kontraktues.
27. Si përfundim, sa më sipër, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara

nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.
2. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 26 Shtator 2022 deri në 26 Tetor 2023.
3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës brenda datës 30 Nëntor 2023.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1027, Datë 26. 10. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË BIZNESIT TARGET TË SHOQËRISË ARTEMIS OOD NGA SHOQËRIA SMURFIT KAPPA BULGARIA EOOD.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Biznesit Target të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Biznesit Target të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi transaksionin e propozuar për blerjen e një pjese të biznesit të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD.

Referuar “Marrëveshja e shitblerjes së aseteve dhe pjesës vijuese”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Smurfit Kappa Bulgaria EOOD është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e

themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: prodhimi i kutive, kasave dhe tabakave të kartonit të valëzuar, makineri prerëse dhe ngjitëse dhe flexoprint. Produktet e saj kryesore përfshijnë karton të valëzuar me 2, 3 dhe 5 shtresa, kuti picash, kuti të vrimëzuara, kuti të tipit teleskop, kuti dhe tabaka të tipit dosje, kuti të tipit rrëshqitës, kuti të tipit të fortë, kuti të gatshme me ngjitje dhe ndarje. Smurfit Kappa Bulgaria EOOD kontrollon nga Smurfit Kappa Group plc (Smurfit plc), shoqëria mëmë e grupit.

Smurfit Kappa Bulgaria EOOD nuk është prezente në Shqipëri por ka realizuar xhiro nga shitjet e papërfillshme të produkteve bag-in-box për vitin 2022.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Artemis OOD është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Bullgarisë. Artemis OOD është një shoqëri e angazhuar në biznesin e prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së paketimeve në kuti (bag-in-box) në Bullgari dhe jashtë saj. Artemis OOD bën shitjen e qeseve për produktin bag-in-box në ushqime, nënsegmentet: a) bulmet; b) pije; c) ëmbëlsira.

Shitësi 2: Hel Bul Estate OOD është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Bullgarisë. Hel Bul Estate OOD operon në tregun e pronave të paluajtshme.

Shoqëria Target: Biznesi Target përbëhet nga biznesi bag-in-box i Artemis OOD dhe pronat e Hel Bul Estate OOD, të cilat përdoren në lidhje me një biznes të tillë.

Biznesi Target nuk ka realizuar shitje në Shqipëri për vitin 2022.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Smurfit Kappa Bulgaria EOOD (blerësi), shoqërisë Artemis OOD (shitësi 1) dhe shoqërisë Hel Bul Estate OOD (shitësi 2) është lidhur “Marrëveshja e shitblerjes së aseteve dhe pjesës vijuese”, e nënshkruar datë 27 korrik 2023.

Artemis OOD është një shoqëri e angazhuar në biznesin e prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së ambalazheve në kuti në Bullgari dhe jashtë saj (Biznesi BIB) dhe në Biznesin e Metalit.

Shoqëria Artemis OOD dëshiron të shesë dhe transferojë tek Blerësi dhe Blerësi dëshiron të blejë pjesën e veçantë dhe të pavarur të veprimtarisë së Artemis OOD, që i përket vetëm Biznesit BIB, të gjithë grupin e të drejtave, detyrimeve dhe marrëdhënieve faktike të Artemis OOD në lidhje me Biznesin BIB.

Shoqëria Hel Bul Estate OOD dëshiron të shesë dhe transferojë tek Blerësi dhe Blerësi dëshiron të blejë pronat e Hel Bul Estate OOD.

Palët synojnë të mbyllin transaksionin e propozuar sapo të jenë plotësuar të gjitha kushtet paraprake dhe të jenë marrë të gjitha aprovimet e nevojshme, përfshirë miratimet nga Autoriteti Bullgar, Autoriteti Shqiptar, Autoriteti Maqedonas, Autoriteti Serb dhe Autoriteti Spanjoll i Konkurrencës.

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se: “Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose aseteve të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre aseteve. Përfitim i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.”

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të Biznesit Target të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e

konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i paketimeve fleksibël, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të Biznesit Target të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD.

Smurfit Kappa Bulgaria EOOD është një shoqëri e angazhuar në prodhimin e kutive, kasave dhe tabakave të kartonit të valëzuar, makineri prerëse dhe ngjitëse dhe flexoprint. Smurfit Kappa Bulgaria EOOD zotërohet nga Smurfit Kappa Group plc., aktive në industrinë e kartonit të valëzuar, duke prodhuar zgjidhje për paketimin me letër në një shkallë globale.

Smurfit Kappa Group nuk është prezente në Shqipëri por ka realizuar xhiro nga shitjet e papërfillshme të produkteve bag-in-box për vitin 2022.

Biznesi Target përbëhet nga biznesi bag-in-box i Artemis dhe pronat e Hel Bul të cilat përdoren në lidhje me një biznes të tillë.

Biznesi Target nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktivitetëve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

3. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Biznesit Target të shoqërisë Artemis OOD nga shoqëria Smurfit Kappa Bulgaria EOOD.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1028, Datë 26. 10 .2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ABO WIND WP FLECHTDORF GMBH & CO. KG NGA SK WIND GMBH & CO. KG.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 10. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG nga SK Wind GmbH & Co. KG.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABO ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG nga shoqëria SK Wind GmbH & Co. KG,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG nga shoqëria SK Wind GmbH & Co. KG, njoftim i cili është depozituar jashtë afatit 30 ditor nga lidhja e marrëveshjes, duke mos plotësuar kriteret e nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Referuar “Marrëveshjes për blerjen dhe transferimin e aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: SK Wind GmbH & Co. KG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë . Shoqëria është aktive në menaxhimi i aseteve dhe të gjitha

aktiviteteve që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me to, në veçanti me funksionimin e fermave të erës në Gjermani dhe Francë.

Shoqëria SK Wind GmbH & Co. KG zotërohet 100% nga Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe kjo e fundit zotërohet nga shoqëria Statkraft Germany GmbH, me seli në Düsseldorf, Gjermani. Të gjitha shoqëritë janë pjesë e Statkraft Group, ku Statkraft AS është shoqëria mëmë e tyre dhe zotërohet tërësisht nga Statkraft SF.

Grupi Statkraft është lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në datë 25.07.2018, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar më datë 17.12.2008, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit, përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: ABO Wind Aktiengesellschaft është një shoqëri publike, e regjistruar sipas legjislacionit Gjerman. Objekti i shoqërisë është fillimi, konsultimi, planifikimi, zhvillimi, funksionimi dhe menaxhimi në lidhje me projektet që kontribuojnë në një furnizim miqësor me mjedisin, veçanërisht përdorimin e energjisë së erës, tregtimin e impianteve të prodhimit të energjisë dhe vendndodhjet për impiantet e prodhimit të energjisë.

Shoqëria Target: ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë. Objektivi kryesor i shoqërisë është realizimi i Flechtdorf përmes planifikimit, ndërtimit dhe funksionimit të turbinave të reja me erë.

Shoqëria B&F Windpark GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionit gjerman.

Shoqëria target është një shoqëri projekt (SPV), e themeluar për të zhvilluar dhe operuar një projekt për prodhimin e energjisë nga era të quajtur "Flechtdorf", në bashkinë e Diemelsee në Hessen, Gjermani.

Shoqëria target nuk ka prezencë ligjore dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Në datë 12 maj 2023 mes shoqërive ABO Wind AG (shitësi); B&F Windpark GmbH (ish Partneri i Përgjithshëm) dhe SK Wind GmbH & Co. KG (blerësi); Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH (Partneri i Përgjithshëm) është nënshkruar "Marrëveshje për blerjen dhe transferimin e aksioneve".

Objekt i blerjes janë aksionet e shitësit, me të gjitha të drejtat dhe llogaritë ndihmëse të shitësit tek shoqëria ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG.

Me plotësimin e të gjitha kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, ku shitësi është i detyruar të njoftojë me shkrim blerësin, shoqëria SK Wind GmbH & Co. KG do të zotërojë 100% të kapitalit në shoqërinë ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG nga shoqëria SK Wind GmbH & Co. KG.

SK Wind GmbH & Co. KG zotërohet indirekt nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet burimeve solare dhe të ujit.

Shoqëria target ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co.KG ushtron aktivitet në fushën e prodhimit të energjisë se rinovueshme, energjisë së erës dhe nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABO Wind WP Flechtdorf GmbH & Co. KG nga SK Wind GmbH & Co. KG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1029, Datë 03. 11. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË 41% TË KUOTAVE TË SHOQËRISË ITALIA TRASPORTO AEREO S.P.A. NGA SHOQËRIA DEUTSCHE LUFTHANSA AKTIENGESELLSCHAFT”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03. 11. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 41% të kuotave të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A., nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A., nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë,

VËREN SE :

(Konfidenciale)

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 41% të kuotave të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1030, Datë 03. 11. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË PARQUE EÓLICO LITUECHE SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03. 11. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi mbi përfimin e kontrollit të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Referuar “Marrëveshjes për Shitblerjen e Kuotave”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A. është një shoqëri aksionare, e organizuar sipas ligjeve të Kilit. Objekti i veprimtarisë së saj është i përqendruar në gjenerimin, transmetimin,

shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike.

Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A. zotërohet nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, shoqëri e grupit Statkraft, një shoqëri lider në prodhimin e energjisë hidrike në arenën ndërkombëtare dhe asaj të rinovueshme në Europë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, shoqëri aksionare me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: Plan-8 Energía Infinita Limitada, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Kilit.

Plan-8 Energía Infinita Limitada zotëron 100% të kuotave të shoqërisë target Parque Eólico Litueche SpA.

Shoqëria Target: Parque Eólico Litueche SpA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Kilit. Shoqëria po zhvillon një projekt për erën për prodhimin e energjisë elektrike, me një kapacitet të instaluar të parashikuar prej 50 MW, i cili do të vendoset në qytetin Litueche (*Projekti Litueche*) në Kili. Projekti Litueche përfshin gjithashtu lidhjen me Nënstacionin Elektrik Cardonal, kanalizimin e kablove elektrike nëntokësore dhe ajrore, rrugët hyrëse, rrugët lidhëse ndërmjet turbinave me erë dhe dhomën e kontrollit në Projekt. Shoqëria target është aktive në tregun e zhvillimit të projekteve të gjenerimit të energjisë së rinovueshme nga burime jo-konvencionale në Kili.

Shoqëria target nuk është prezente dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 05 shtator 2023, është lidhur “Marrëveshje për Shitblerjen e Kuotave”, ndërmjet shoqërive Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A. në cilësinë e blerësit dhe Plan-8 Energía Infinita Limitada, në cilësinë e shitësit.

Në varësi të respektimit të kushteve pezulluese, shoqëria Plan-8 Energía Infinita Limitada merr përsipër të shesë, caktojë dhe transferojë te blerësi, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, merr përsipër të blejë, secilin prej aksioneve të shoqërisë, liruar nga të gjitha barrët.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e 100% të aksioneve të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvencionale, por duke qenë se transaksioni nuk

do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A zotërohet nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, pjesë e grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Parque Eólico Litueche SpA, një shoqëri kiliane, e themeluar posaçërisht për të implementuar projektin e një ferme ere në Kili, aktualisht në një stad zhvillimi të avancuar, nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri. Pas vendosjes në operim, projekti do të kenë ndikim vetëm në tregun e energjisë së Kilit.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Parque Eólico Litueche SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1031, Datë 03.11.2023

“ MBI MIRATIMIN E LOGOS SË RE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03. 11. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimi i logos së re të Autoritetit të Konkurrencës

Baza Ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa d) dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi propozimin për miratimin e logos së re të Autoritetit të Konkurrencës”,

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës, si pjesë vizive të imazhit të tij, ka logon e Institucionit. Logo është simboli i institucionit, i cili përdoret në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, në rrjetet sociale, në aktivitetet që Autoriteti organizon, si dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit që Autoriteti i Konkurrencës nënshkruan me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Sekretariati zhvilloi procedurat për krijimin e logos së re të Autoritetit të Konkurrencës, sipas kërkesave për projektin e logos, e cila në përmbajtje të saj ka:

- Shigjetat që simbolizojnë dinamikat e tregjeve, forcat konkurrenciale;
- Ngjyrat e kuqe dhe e zezë, simbole kombëtare;
- Shigjetat të cilat formojnë me ndërthurje shkronjat A dhe K si initiale të Autoritetit të Konkurrencës;

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, shqyrtoi variantet e propozuara.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin për ndryshimin e logos së Autoritetit të Konkurrencës, sipas modelit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hy në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1032, Datë 14. 11. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE STATKRAFT WINDENERGIE GMBH & CO.KG DHE EOLIENNES SUROIT SNC NGA SHOQËRITË STATKRAFT GERMANY GMBH, STATKRAFT HOLDING WIND & SOLAR DEUTSCHLAND GMBH DHE STATKRAFT RENOUEVELABLES SASU”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 11. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG dhe Eoliennes Suroit SNC nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG dhe Eoliennes Suroit SNC nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi mbi përfitim e kontrollit, në lidhje me blerjen e propozuar të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr. 982, datë 11.05.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 457, datë 23.08.2023 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar se shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu kanë lidhur “Marrëveshje Shitblerje”.

Referuar “Marrëveshjes Shit-blerje”, datë 31 korrik 2023, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala Blerëse:

Blerësi 1: Statkraft Germany GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: blerja, veprimtaria holding, administrimi dhe shitja e aksioneve në shoqëri të tjera dhe kryerja e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me to.

Blerësi 2: Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: blerja, shitja dhe administrimi i aksioneve të shoqërisë.

Blerësi 3: Statkraft Renouvelables Sasu është një shoqëri aksionare e thjeshtuar, e themeluar sipas legjislacionit francez, me objekt aktiviteti projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve të energjisë elektrike, marrjen e angazhimeve financiare ose materialeve në tregtimin e energjisë dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me to etj.

Blerësit janë pjesë e Grupit Statkraft. Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Statkraft Renewables Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA është një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 Mw në Luginën e Devollit, përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Breeze Two Energy GmbH & Co.KG është një partneritet i kufizuar, i themeluar sipas legjislacionit gjerman, i cili zotërohet nga Breeze Two GmbH, që vepron si ortak me përgjegjësi të pakufizuar dhe Ocorian Trust (Cayman) Limited, Grand Cayman/Ishujt Cayman, që vepron si ortak me përgjegjësi të kufizuar.

Breeze Two Energy GmbH & Co.KG është zotërues i asetëve të projekteve gjermane, të cilat janë në pronësi të tij (fermat e erës). Gjithashtu Breeze Two Energy GmbH & Co.KG zotëron pjesëmarrje në shoqëritë e quajtura “Shoqëritë e Infrastrukturës Gjermane”, të cilat menaxhojnë aksesin në rrjetin e energjisë.

Breeze Two Energy GmbH & Co.KG zotëron 100% Breeze Two Energy Trust Corporation GmbH (filial i Breeze Two Energy GmbH & Co.KG).

Shitësi 2: Breeze Two GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: menaxhimin e asetëve nën zotërim.

Shoqëritë Target:

Target 1: Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG (Partneriteti) është një partneritet i kufizuar, i themeluar sipas legjislacionit gjerman, i cili zotërohet nga ortakët Breeze Two Energy GmbH & Co.KG (ortaku me përgjegjësi të pakufizuar në Partneritet) dhe Breeze Two Energy Trust Corporation GmbH (ortaku me përgjegjësi të kufizuar në Partneritet). Tek shoqëria Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG (Partneriteti) u transferuan feramat gjermane që zotëroheshin dhe operoheshin nga Shitësi 1, sipas Marrëveshjes së Transferimit të Biznesit. Projekti gjerman përmban 35 ferma për energjinë nga era.

Target 2: Eoliennes Suroit SNC (Shoqëria e Projektit Francez) është një partneritet sipas legjislacionit francez, i cili zotërohet nga Breeze Two Energy GmbH & Co.KG dhe Breeze Two GmbH. Projekti francez operon katër (4) ferma për energjinë nga era.

Shoqëritë target nuk janë prezentë dhe nuk gjenerojnë të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 31 korrik 2023, ndërmjet Breeze Two Energy GmbH & Co.KG (shitësi 1), Breeze Two GmbH (shitësi 2), Statkraft Germany GmbH (Blerësi 1), Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH (Blerësi 2), Statkraft Renouvelables Sasu (Blerësi 3), B2E Partners GmbH & Co.KG (Partneriteti) dhe Pepe Foundation Trust është nënshkruar Marrëveshje Shit-Blerje.

Referuar kësaj Marrëveshjeje, Shitësi 1 transferon tek Blerësi 1: a) cilësinë si pronar përfitues i Partneritetit; b) interesat e tij si ortak me përgjegjësi të pakufizuar tek partneriteti; c) pozicionin e tij si krijues i trustit (Breeze Two Energy Trust Corporation GmbH) sipas marrëveshjes së trustit; d) cilësinë si ofrues shërbimesh sipas Marrëveshjes së Shërbimit.

Shitësi 1 transferon tek Blerësi 2: a) të gjitha kuotat që zotëron tek filiali i tij Breeze Two Energy Trust Corporation GmbH; b) cilësinë e kujdestarit sipas marrëveshjes së trustit. Rrjedhimisht me përfundimin e kontrollit në shoqërinë Breeze Two Energy Trust Corporation GmbH, Blerësi 2 do të shndërrohet në administruesin e trustit.

Shitësi 1 dhe Shitësi 2 do të transferojnë të gjitha kuotat e shoqërisë Eoliennes Suroit SNC tek Blerësi 3.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërive Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG dhe Eoliennes Suroit SNC nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të

nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërive Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG dhe Eoliennes Suroit SNC nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu.

Blerësit Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu, janë pjesë e Grupit Statkraft, i cili është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë target, të cilat përfshijnë portofolin gjerman dhe portofolin francez, nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri. Ato janë të angazhuara në prodhimin e energjisë nga projektet e energjisë nga era në Gjermani dhe Francë.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërive Statkraft Windenergie GmbH & Co.KG dhe Eoliennes Suroit SNC nga shoqëritë Statkraft Germany GmbH, Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH dhe Statkraft Renouvelables Sasu.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1033, Datë 14. 11. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË ROUTE MOBILE LIMITED NGA SHOQËRIA PROXIMUS OPAL”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 11. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Route Mobile Limited nga shoqëria Proximus Opal.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e propozuar të aksioneve të shoqërisë Route Mobile Limited nga shoqëria Proximus Opal,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Route Mobile Limited nga shoqëria Proximus Opal.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, nënshkruar më datë 17 korrik 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Proximus Opal është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas

legjislacionit të Belgjikës. Veprimtaria kryesore e shoqërisë Proximus Opal është të veprojë në cilësinë e likuiduesit ose administruesit/menaxhuesit dhe të përfitojë pjesëmarrje me ofertë publike ose private në kapitalin e institucioneve, shoqërive, ndërmarrjeve, dhe/ose organizatave, belge, të huaja ose ndërkombëtare, që kanë të njëjtë, të ngjashëm ose të lidhur, ose në të cilat Proximus zotëron pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

Proximus Opal është filial i Proximus, pjesë e Grupit Proximus. Grupi Proximus nëpërmjet filialeve të tij është aktiv në një gamë të gjerë shërbimesh të komunikimeve elektronike me shumicë dhe pakicë, telekomunikacion fiks dhe celular, shërbime zanore dhe shërbime të dhënash.

Proximus Opal nuk është prezent, por realizon xhiro në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij BICS nga shitjet në tregun ndërkombëtar të shërbimeve të telekomunikacionit të operatorëve me shumicë.

Garantuesi i Blerësit: Proximus është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me ofertë publike), e organizuar sipas ligjeve të Belgjikës. Shoqëria është e listuar në bursën e Brukselit.

Pala shitëse: Shitësit janë persona fizikë, familjarë të familjes Gupta, së bashku me subjektet e tyre të lidhura.

Shoqëria Target: Route Mobile Limited është një shoqëri indiane, e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, me seli të regjistruar në Mumbai.

Route Mobile Limited ofron përvoja të konsumatorëve të lidhur në kohë reale me platformën e saj të avancuar të komunikimit si shërbim të bazuar cloud (renë) kompjuterike (CPaaS), në nivel ndërkombëtar. Route Mobile u shërben ndërmarrjeve, ofruesve të shërbimeve over-the-top dhe operatorëve të rrjetit celular. Route Mobile Limited ofron një paketë të plotë produktesh komunikimi, bazuar në parimet e një CPaaS, duke “injektuar” inteligjencë artificiale ndërvepruese në një gamë të gjerë industrish, përfshirë shoqëritë e mediave sociale, bankat dhe institucionet financiare, entitetet e tregtisë elektronike dhe agjencitë e udhëtimeve.

Route Mobile Limited është aktive në mbarë botën nëpërmjet filialeve të saj.

Route Mobile Limited nuk është prezent, por realizon xhiro në Shqipëri nëpërmjet shërbimeve të telekomunikacionit të operatorëve me shumicë bazuar në terminimin / destinacionin e trafikut në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Proximus Opal (blerësi), Proximus (Garantuesi), dhe secili nga individët dhe subjektet të përcaktuara në shtojcën 1 (shitësit) është lidhur “Marrëveshje për blerjen e aksioneve” (në lidhje me shitjen dhe blerjen e aksioneve në Route Mobile Limited), datë 17 korrik 2023.

Bashkëlidhur kësaj Marrëveshje është nënshkruar po më datë 17 korrik 2023 “Akt Pranimi, lidhur me projektin Globetrotter”, ndërmjet palëve Proximus Opal, Proximus, Clear Bridge Ventures LLP dhe Sandipkumar Chandrakant Gupta, Rajdipkumar Chandrakant Gupta.

Sipas këtij akti palët Proximus Opal, Proximus dhe grupi i shitësve kanë lidhur një marrëveshje të parë për blerjen e aksioneve, sipas së cilës shoqëria Proximus Opal ka rënë dakort në varësi të kushteve dhe termave të përcaktuara në “Marrëveshjen për blerjen e aksioneve”, për të blerë 57,56% të kapitalit aksioner të zgjeruar të votimit të shoqërisë Route Mobile Limited nga grupi i shitësve.

Ky transaksion do të pasohet nga një ri investim i të ardhurave nga shitja e një pjese të kuotave të disa prej shitësve nëpërmjet shoqërisë Clear Bridge Ventures LLP, tek shoqëria Proximus Opal, në përputhje me “Marrëveshjen për blerjen e aksioneve”, të nënshkruar më datë 17 korrik 2023, ndërmjet Proximus dhe Clear Bridge Ventures LLP, në mënyrë që Clear Bridge Ventures LLP të zotërojë deri në masën 14,50% të aksioneve të pashlyera të Proximus Opal, duke zotëruar një pakicë jo-influencuese

në këtë të fundit.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i Platformës së Komunikimit si Shërbim (CPaaS), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Evropian i përcakton zgjidhjet CPaaS si zgjidhje të softuerit të mesëm me bazë Cloud të cilat integrojnë kanalet e komunikimit (të tilla si zëri, emaili, sms, biseda në internet dhe over-the-top (OTT)). Kanalet e mesazheve OTT janë kanale mesazhesh që ofrohen nëpërmjet një lidhje interneti në krahasim me kanalet e mesazheve që ofrohen nëpërmjet një rrjeti celular, si Sms. Kanalet e mesazheve OTT përfshijnë kanalet e mesazheve të Meta dhe kanalet e mesazheve të palëve të treta si mesazhet Twitter DM, Telegram, Line dhe WeChat, në aplikacionet e tyre ndërmjet ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API).

Për nga vetë natyra, CPaaS ofrohet në një treg të dimensionit global. Kur bëhet fjalë për informacionin përkatës të tregut ndërkombëtar, duhet të theksohet se një informacion i tillë mund të shprehet si i bazuar në vendndodhjen ku komunikimi / mesazhi në fjalë terminohet / ndërpritet përfundimisht.

Grupit Proximus është aktiv në një gamë të gjerë shërbimesh të komunikimeve elektronike me shumicë dhe pakicë, telekomunikacion fiks dhe celular, shërbime zanore dhe shërbime të dhënash. Asnjë nga filialet e Grupit Proximus nuk ka aktualisht konsumatorë në Shqipëri për shërbimet CPaaS. Mesazhet që gjenerohen nëpërmjet shërbimeve që ata shesin diku tjetër në botë, mund të kenë nevojë të terminohen në Shqipëri.

Grupi i Target gjeneron të ardhura të ulëta në Shqipëri nga shitja e shërbimeve CPaaS. Vetëm një pjesë e papërfillshme e shërbimeve CPaaS të Grupit Target u shiten konsumatorëve brenda Shqipërisë. Xhiro përfshin edhe të ardhura që ato gjenerojnë nëpërmjet shërbimeve të tyre CPaaS në mbarë botën, të cilat përfundimisht terminohen në Shqipëri. Kjo do të thotë se shifrat e këtyre të ardhurave nuk gjenerohen nga shitjet për konsumatorët në Shqipëri, por lidhen me mesazhet e terminuara në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Route Mobile Limited nga shoqëria Proximus Opal.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1034, Datë 05. 12. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM NGA SHOQËRIA CSIC LONGJIANG GH GAS TURBINE CO., LTD MBI ASETET E BIZNESIT TË TURBINAVE ME GAZ TË MAN ENERGY SOLUTIONS SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE,

VËREN SE :

(Konfidenciale)

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë

28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co., Ltd mbi asetet e Biznesit të turbinave me gaz të MAN Energy Solutions SE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1035, Datë 05. 12. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË VOLVO BUSINESS SERVICES INTERNATIONAL AB DHE RENAULT S.A.S”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s,

VËREN SE :

(Konfidenciale)

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1036, Datë 12. 12. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË DONI FRUITS SHPK NGA SHOQËRIA GJONAJ GROUP HOLDINGS SHPK DHE Z. EJUP AHMETI”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti.

Referuar dokumentit “Marrëveshjes për Shit-Blerjen e Kuotës”, datë 23.11.2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Gjonaj Group Holdings SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Investime në instrumente financiare, të cilat përfshijnë pa kufizim titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare (kuotat dhe aksionet), titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh, obligacione private ose publike ndërkombëtare etj, themelimin dhe zotërimin e shoqërive tregtare, pjesërisht ose tërësisht, investime

në pasuri të luajtshme dhe paluajtshme, ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj, tërësisht ose pjesërisht, dhe / ose të tretë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në konsulencën e natyrës financiare, menaxheriale, ligjore, IT, zhvillim software-sh etj.

Gjonaj Group Holdings SHPK zotërohet 100% nga Z. Marin Gjonaj.

Shoqëri të kontrolluara nga blerësi Gjonaj Group Holdings SHPK janë:

-ENER TRADE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import, eksport dhe tregtim i energjisë elektrike. Ortakët e shoqërisë janë shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Artur Mickaj me 50% të kapitalit secili.

-Professional Marketing Albania SHPK (shoqëria e përthithur "PROM FB"), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ofrimi i shërbimeve në fushën e marketingut, telemarketingu dhe teleshitje. Ortak i vetëm i shoqërisë është shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK.

-ProBroker SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtari në menaxhimin dhe administrimin e pronave të paluajtshme dhe të ndërtesave. Ortakët e shoqërisë janë shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Fabio Gjonaj me 50% të kapitalit secili

-INFO-Telecom SHPK është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ofrimi i shërbimeve në fushën e telekomunikacionit. Ortak i vetëm i shoqërisë është shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK.

Shoqëria INFO-Telecom SHPK zotëron 80% të kuotës në shoqërinë Infotelecom-Albsolar 2 SHPK dhe 20% zotërohen nga Tirana International Development, zotëron 100% të kuotës në shoqërinë Infotelecom-Albsolar 1 SHPK dhe 40% të kuotës në shoqërinë AMB Construction SHPK.

-Infotelecom-Albsolar 3 SHPK është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar. Ortakët e shoqërisë janë shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK me 51% të kapitalit dhe shoqëria Alberg me 49% të kapitalit. Infotelecom-Albsolar 3 SHPK zotëron 100% kapitalin e shoqërisë GreenNat Solar Park Ballsh.

Gjithashtu shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK zotëron 50% të kuotës në shoqërinë ETMT SHPK.

Pala shitëse: Z. Burim Ahmeti është person fizik, i cili zotëron 50% të kuotës në shoqërinë DONI FRUITS SHPK.

Shoqëria Target: DONI FRUITS SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: grumbullim, magazinim, ruajtje, eksport fruta-perime dhe importe të ndryshme. Tregti fruta-perime me shumicë dhe pakicë brenda vendit.

Aktualisht shoqëria DONI FRUITS SHPK sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar, zotërohet nga z. Ejup Ahmeti me pjesëmarrje 50% të kuotës dhe z. Burim Ahmeti me pjesëmarrje 50% të kuotës.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Gjonaj Group Holdings SHPK (blerësi), Z. Burim Ahmeti (shitësi), Z.Ejup Ahmeti (ortaku miratues) dhe znj. Antigona Ahmeti (dhënësjë e pëlqimit) është lidhur "Marrëveshje për Shit-Blerjen e Kuotës", më datë 23.11.2023.

Referuar objektit dhe qëllimit të transaksionit sipas nenit 2 i kësaj kontrate, bazuar në afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshje, në mbyllje, shitësi do të shesë dhe transferojë blerësit kuotën dhe blerësi do të blejë 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë DONI FRUITS SHPK dhe çdo të drejtë që i përket kuotës.

Pas përfundimit të transaksionit Gjonaj Group Holdings SHPK do të zotërojë 1(një) kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të DONI FRUITS SHPK dhe Z.Ejup Ahmeti do të zotërojë 1(një) kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të DONI FRUITS SHPK. Kalimi i pronësisë mbi kuotën nga shitësi tek blerësi do të ndodhë në datën e mbylljes në përputhje me kushtet dhe afatet e Marrëveshje. Data e mbylljes do të jetë data e marrjes së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës ose dita e parë e punës pas kësaj date.

Shitësi dhe Blerësi kanë përcaktuar bashkërisht se, pronësia e kuotës do të transferohet nga shitësi tek blerësi vetëm pas pagimit të çmimit të plotë dhe plotësimit të kushteve paraprake.

Marrëveshja parashikon që në datën e mbylljes Shitësi do të nënshkruajë: (i) memorandumun që konfirmon mbushjen e Kushteve Paraprake, (ii) Marrëveshjen për Kalimin e Kuotës, etj.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

Tregu përkatës i produktit: Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i import-eksportit dhe tregtimit të fruta perime.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *tregu përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të përbashkët i shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti.

Gjonaj Group Holdings SHPK është aktive në investimin në instrumente financiarë, themelimin dhe zotërimin e shoqërive tregtare, ofrimin e shërbimeve të konsulencës etj. Gjonaj Group Holdings SHPK dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj nuk janë aktive në tregun e import-eksportit të fruta perimeve.

Shoqëria target DONI FRUITS SHPK është aktive në import-eksportin e frutave dhe perimeve dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i tyre.

Transaksioni synon rritjen e aktivitetit të palës blerëse nëpërmjet realizimit të investimeve të reja.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë DONI FRUITS SHPK nga shoqëria Gjonaj Group Holdings SHPK dhe Z. Ejup Ahmeti.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1037, Datë 12. 12. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË LEVI RALLY CENTER OY NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT, NËPËRMJET SHOQËRISË PORSCHE INVESTMENTS MANAGEMENT S.A.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12. 12 .2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Levi Rally Center Oy nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Levi Rally Center Oy nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Levi Rally Center Oy nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shit-blerje kuotash”, datë 02 tetor 2023, palët janë:

Pala blerëse: Porsche Investments Management S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Luksemburgut. Objekti i shoqërisë është: të blejë pjesëmarrje dhe kuota, në çfarëdo forme, në Luksemburg dhe në shoqëri të tjera ose ndërmarrje të huaja tregtare; të përfutojë tituj, të drejta dhe interesa në aktive me anë të pjesëmarrjes, kontributit, nënshkrimit, blerjes ose opsionit, negocimit dhe të transferojë tituj të çdo lloji me anë të shitjes etj.

Porsche Investments Management S.A. është një filial i Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, është një shoqëri publike, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Prodhimin dhe shitjen automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, duke përfshirë avionët dhe mjetet ujore, si dhe pjesëve, aksesorëve për produkte të tilla dhe të tjera teknike, etj. Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, kompania mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen, operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Palët shitëse: Shitësit janë z. J.Y. dhe z. V.P.W., persona fizikë, shtetas të huaj dhe 5 shoqëri të huaja me përgjegjësi të kufizuar, dhe konkretisht: [...].

Shoqëria Target: Levi Rally Center Oy është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Finlandës, e cila ushtron aktivitetin si qendër dimërore për drejtimin e automjeteve dhe ofron programe drejtimi të automjeteve dimërore të dizenuara kryesisht për klientët privatë, si edhe testime dimërore dhe ngjarje të dizenuara për klientët e korporatave në Finlandë.

Levi Rally Center Oy nuk ka prezencë të regjistruar në Shqipëri dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A. (blerësi), z. J.Y. (shitësi 1), z. V.P.W. (shitësi 2), shoqërisë [...] (shitësi 3), shoqërisë [...] (shitësi 4), shoqërisë [...] (shitësi 5), shoqërisë [...] (shitësi 6) dhe shoqërisë [...] (shitësi 7) është lidhur “Marrëveshje shit-blerje kuotash”, në lidhje me shit-blerjen e 100% të kuotave të Levi Rally Center Oy, datë 02 tetor 2023.

Referuar kësaj marrëveshje, shitësit kanë pronësinë e plotë të kuotave, të cila ia shesin blerësit dhe blerësi blen kuotat nga shitësit, sipas termave dhe kushteve në këtë marrëveshje. Pronësia dhe titulli mbi kuotat, të cilat do të jenë të lira dhe pa barrë, do të kalojnë nga shitësi tek blerësi në datën e mbylljes kundrejt pagesës së çmimit të blerjes.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A., do të zotërojë 100% shoqërinë target Levi Rally Center Oy.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimit

nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si edhe praktikave evropiane në raste të ngjashme, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ofrimit të ambjenteve dhe programeve për testimin dimëror të automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Levi Rally Center Oy nga shoqëria Dr.Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A.

Porsche Investments Management S.A. zotërohet nga Dr. Ing. H.c. F. Porsche Aktiengesellschaft, pjesë e grupit Volkswagen.

Grupit Volkswagen është aktiv në mbarë botën për zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave për transportin e pasagjerëve, makinave komerciale, kamionëve, autobuzëve, trajlerave, shasive për autobusë dhe motorë benzine, motoçikleta, duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore për to. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, por nuk është prezent në Shqipëri në tregun përkatës. Aktiviteti i tyre në Shqipëri konsiston kryesisht në shitjen e automjeteve të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare.

Levi Rally Center Oy ushtron aktivitetin si qendër dimërore për drejtimin e automjeteve dhe ofron programe drejtimi të automjeteve dimërore të dizenuara kryesisht për klientët privatë, si edhe teste dimërore dhe ngjarje të dizenuara për klientët e korporatave në Finlandë.

Target nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Levi Rally Center Oy nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, nëpërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1038, Datë 22. 12 .2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË KAPITALIT AKSIONAR TË SIMON & SCHUSTER (UK) LTD DHE SIMON & SCHUSTER, INC. NGA CENTURY DE BUYER LLC DHE CENTURY UK BUYER LTD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kapitalit aksionar të Simon & Schuster (UK) Ltd dhe Simon & Schuster, Inc. nga Century DE Buyer LLC dhe Century UK Buyer Ltd.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kapitalit aksionar të Simon & Schuster (UK) Ltd dhe Simon & Schuster, Inc. nga Century DE Buyer LLC dhe Century UK Buyer Ltd,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

[... *konfidenciale*...]

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së kapitalit aksionar të Simon & Schuster (UK) Ltd dhe Simon & Schuster, Inc. nga Century DE Buyer LLC dhe Century UK Buyer Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1039, Datë 22. 12. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË WESTROCK COMPANY NGA SHOQËRIA SMURFIT KAPPA GROUP PLC”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë WestRock Company nga shoqëria Smurfit Kappa Group plc.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë WestRock Company nga shoqëria Smurfit Kappa Group plc,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi transaksionin e propozuar për përfutimin e kontrollit të shoqërisë WestRock Company nga shoqëria Smurfit Kappa Group plc.

Referuar “Marrëveshje transaksioni”, palët në marrëveshje janë:

Pala 1: Smurfit Kappa Group plc (Blerësi) është një shoqëri e kufizuar publike, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, aktive në industrinë e prodhimit të kartonit të valëzuar, duke prodhuar zgjidhje për paketimin me letër në një shkallë globale.

Smurfit Kappa Group plc është e listuar në Bursat e Irlandës dhe Londrës dhe aksionet e saj janë të shpërndara gjerësisht. Smurfit Kappa Group plc është shoqëria mëmë irlandeze e Grupit Smurfit

Kappa.

Smurfit Kappa Group nuk është prezente në Shqipëri por ka realizuar xhiro nga shitjet e papërfillshme të produkteve bag-in-box për vitin 2022.

Pala 2: Cepheidway Limited është një shoqëri private e kufizuar e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Irlandës. Kjo shoqëri do të rëmërohet dhe ri-regjistrohet si Smurfit WestRock plc.

Pala 3: Sun Merger Sub, LLC është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në shtetin e Delaware. Kjo shoqëri është një degë e grupit SmurfitWestRock.

Pala 4: WestRock Company (Shoqëria target) është një korporatë e themeluar në shtetin e Delaware. WestRock Company është një ofrues shumëkombësh i zgjidhjeve inovative dhe të qendrueshme të letrës dhe paketimit, me impiante prodhuese në Europë, si dhe në Amerikën e veriut, Amerikën e jugut, Azi dhe Australi.

WestRock Company është e listuar në Bursën e Nju Jorkut dhe aksionet e saj janë të shpërndara gjerësisht.

WestRock Company nuk është aktive dhe nuk ka filiale, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 12 shtator 2023, shoqëritë Smurfit Kappa Group plc (Blerësi), Cepheidway Limited (rëmërohet dhe ri-regjistrohet si Smurfit WestRock plc), Sun Merger Sub, LLC dhe WestRock Company (Shoqëria target) kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje Transaksioni”.

[...]

Në përfundim, Smurfit Kappa Group plc do të marrë kontrollin e vetëm të Smurfit WestRock plc dhe ky i fundit do të mbajë të gjithë aksionet në Smurfit Kappa Group plc dhe të gjitha aksionet në WestRock Company.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë WestRock Company nga shoqëria Smurfit Kappa Group plc, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i kartonave të palosshëm, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të WestRock Company nga Smurfit Kappa Group plc.

Smurfit Kappa Group plc është një nga ofruesit kryesorë të zgjidhjeve të paketimit me bazë letre në botë.

Smurfit Kappa Group plc nuk është prezente në Shqipëri por ka realizuar xhiro nga shitjet e papërfillshme të produkteve bag-in-box për vitin 2022.

WestRock Company është aktive në prodhimin dhe furnizimin e kartonave të fortifikuar, kartonave të

palosshëm, kartonave mbajtës dhe produkteve të paketimit të valëzuar, midis shërbimeve dhe produkteve të tjera.

Duke marrë parasysh shitjet e papërfillshme të produkteve bag-in-box nga Smurfit Kappa Group plc në Shqipëri dhe gjithashtu se Shoqëria Target nuk është prezent dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri, transaksioni nuk do të ndikojë konkurrencën lidhur me tregun përkatës.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë WestRock Company nga shoqëria Smurfit Kappa Group plc.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1040, Datë 22. 12. 2023

“MBI MIRATIMIN E UDHËZUESIT “MBI PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR ZBULIMIN E INFORMACIONIT NË BAZAT E TË DHËNAVE, GJATË PROCEDURAVE HETIMORE DHE TË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE TË PARASHIKUARA NË LIGJIN NR. 9121, DATË 28.07.2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft-Udhëzuesit “Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në nenin 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VËREN SE :

1. Udhëzuesi i propozuar është përshtatur duke u përafuar me “Praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave të parashikuara në nenin 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”³.
2. Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të jap udhëzime se kur dhe si mund të përdoren baza e të dhënave për të zbuluar, në mënyrë të kufizuar, sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale të përfituara gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Dokumenti synon të rrisë transparencën dhe parashikueshmërinë e procesit brenda kuadrit ekzistues ligjor dhe procedural, duke përmirësuar kështu efektivitetin e hetimeve për antitrustin dhe për përqendrimet.

³ Best Practices on the disclosure of information in data rooms in proceedings under Articles 101 and 102 TFEU and under the EU Merger Regulation (2 June 2015)

3. Në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 9121/2003, AK ka detyrën për ruajtjen e informacionit konfidencial që mund të dëmtojë ndërmarrjen nëse zbulohet. Pavarësisht kësaj, në procedurat për antitrustin, në disa raste, një informacion konfidencial mund të zbulohet, por vetëm në rastet kur zbulimi i tij është i nevojshëm për të vërtetuar një shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, ose me qëllim që të garantohet mundësia e mbrojtjes.
4. Në parim, aksesit në dosjen e AK jepet duke u dhënë palëve që janë njohur me Raportin e Hetimit, akses në një version elektronik të të gjithë dokumenteve që përmban dosja e AK, me përjashtim të dokumenteve të brendshme dhe informacionit konfidencial (psh, sekrete tregtare dhe informacioneve të tjera konfidenciale).
5. AK, sipas gjykimit të saj, vendos nëse një bazë të dhënash është e përshtatshme në një çështje të caktuar. AK vendos që të ofrojë një bazë të dhënash, me iniciativën e saj ose me kërkesë të palëve që janë njohur me Raportin e Hetimit, kur e gjykon të nevojshme dhe proporcionale diçka të tillë bazuar në parimet e përcaktuara më sipër dhe me kusht që çdo vështirësi ligjore dhe praktike të mund të zgjidhet me shpejtësi dhe me dakordësinë e palëve të përfshira drejtpërdrejtë në procedura dhe palët të cilët kanë depozituar të dhëna.
6. Një bazë të dhënash mund të organizohet në çdo kohë kur mund të jepet akses në dosjen e AK (pra, pasi palëve ju është dërguar Raporti i Hetimit dhe kanë mundësinë për t'u dëgjuar para së të merret një vendim). Baza e të dhënave organizohet përpara seancës dëgjimore.
7. Për shkak të sensitivitetit dhe natyrës konfidenciale të të dhënave që përmban baza e të dhënave, aksesit në bazën e të dhënave është i kufizuar në një grup personash, më konkretisht “vetëm për këshilltarët e jashtëm”.
8. Këshilltarët e jashtëm nuk heqin të dhëna, informacione apo dokumente nga baza e të dhënave dhe nuk u japin palëve tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit ose palëve të treta, informacione konfidenciale të përfuara në kuadër të procedurës për bazat e të dhënave. Pikë së pari, këshilltarët e jashtëm duhet të garantojnë se respektojnë rregullat përkatëse të sjelljes profesionale dhe se janë në gjendje të veprojnë mbi bazën e këtyre rregullave.
9. Pas marrjes së aksesit në bazën e të dhënave dhe vetëm gjatë kohës së aksesit në bazën e të dhënave, këshilltarët e jashtëm mund të përgatisin një raport të bazës së të dhënave. Raporti i bazës së të dhënave është instrumenti i vetëm përmes të cilit këshilltarët e jashtëm mund të komunikojnë dhe diskutojnë të dhënat në bazën e të dhënave me palët tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit, të cilët nuk mund të kenë akses në këto të dhëna në një mënyrë tjetër.
10. Këshilltarët e jashtëm nuk heqin asnjë të dhënë, informacion apo dokument nga baza e të dhënave, edhe nëse këto të dhëna, informacione apo dokumente nuk përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.
11. Duke nënshkruar Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë dhe duke rënë dakord me rregullat për bazat e të dhënave, këshilltarët e jashtëm pranojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre që rezultojnë nga procedura për bazat e të dhënave. Nëse një nga këshilltarët e jashtëm nuk respekton rregullat dhe detyrimet, të gjithë këshilltarëve të jashtëm të palës përkatëse do u kërkohej që të largohen menjëherë nga baza e të dhënave.
12. Palët të cilët kanë depozituar të dhëna pranë AK, do të jenë në gjendje të shprehin çdo shqetësim të mundshëm lidhur me procedurën për bazat e të dhënave, për shembull, shqetësimet rreth kundërpërgjigjeve të mundshme nga palët të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit, do të kenë mundësi të shqyrtojnë rregullat për bazat e të dhënave dhe Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë dhe të japin komente, si dhe të rishikojnë listën e këshilltarëve të jashtëm me qëllim identifikimin e konflikteve të mundshme të interesit.

13. Komisioni e bazon vendimin vetëm në pretendime, për të cilat palëve u është dhënë mundësia për t'u shprehur.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1041, Datë 26. 12. 2023

“PËR ZGJEDHJEN E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

Baza Ligjore: Neni 27, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu IX, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Informacion mbi procedurën e konkurrimit për pozicionin: Sekretar i Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit (Njësia Përgjegjëse),

VËREN SE :

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit, me shkresën nr. 569 prot., datë 11.10.2023 ka bërë shpalljen për një vend të lirë pune në pozicionin Sekretar i Përgjithshëm në Autoritetin e Konkurrencës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND”, i ndryshuar, pas vlerësimit paraprak të dokumenteve të kandidatëve, të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, kandidati që ka plotësuar kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për të vazhduar procedurën e pranimit në kategorinë e lartë drejtuese ka rezultuar Z. Endi Çekani.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 6, datë 19.09.2014 “Për procesin e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND”, nga konkurrimi i realizuar në datën 15.12.2023 nga

Komiteti i Përhershëm i Pranimi, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatit, testimi me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, nëpërmjet procedurës së pranimi në kategorinë e lartë drejtuese për pozicionin Sekretar i Përgjithshëm, është shpallur fitues Z. Endi Çekani.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 27, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe VKM nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, Kreu IX, pika 2,

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e Z. Endi Çekani, në pozicionin Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës.
2. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare do të fillojnë në datë 4 janar 2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1042, Datë 26. 12. 2023

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN “UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË” SHA

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vlorë” SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 703 prot. i AK, datë 12.12.2023, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr.46 prot., datë 10.11.2023, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU) dhe të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN).
3. UK Vlorë SHA ka aplikuar tarifën e miratuar nga ERRU sipas Vendimit Nr. 51, datë 28.10.2019 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për UK Vlorë SHA. Ndërmarrja Ujësjetllës

Kanalizime Vlorë SHA synojnë ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në vitin 2024, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori.

4. Ndërmarrja UK Vlorë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot të operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektivi kryesor i ndërmarrjes për vitin 2024. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga UK Vlorë SHA.
5. Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA propozon tarifat e reja si rezultat i nevojës për përmirësim të performancës financiare dhe mbulimin e kostove operationale; për shkak të rritje së çmimeve të materialeve; reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele të larta; përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujit, rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë; realizimi i të ardhurave për përbalimin e kostove shtesë.
6. UK Vlorë SHA ka kërkuar ndryshimin e tarifave, për vendosjen në një nivel të ri pas katër vitesh, të tarifave për shërbimin e FU dhe KUN referuar vlerësimit dhe analizës së kostove për ofrimin e këtij shërbimi.
7. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12. 2021 lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2024 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
8. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA pas miratimit të tarifave të reja do të ketë një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 38.08 % për vitin 2022 me një rritje 57 % për vitin 2024. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 96.25% në vitin 2024.
9. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA duhet të aplikoj urgjentisht pranë ERRU-së për licencimin për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura; Instalimin e matësve në burim (Bulk metër), si edhe matësit familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesit e nivelit të matjes; Të kryejë vlerësimin e “ ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet; Të organizojë taks- forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Vlorë për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzuesit kryesisht për klientët privat(hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale; Të trajnojnë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi UPA; Të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2023 dhe 2024 në vazhdim;

Të gjejë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit, i cili shkakton humbje fizike në nivele të lartë; të mbaj nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimeve të defekteve, për të minimizuar sa me shumë humbjet nga rrjedhjet; Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet; Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2024;

10. Ne aspektin ekonomik, ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Vlorë SHA duhet të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të asetëve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes për këtë qëllim, që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimit të parashikuar për t'u realizuar në vitin 2024; Të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si; monitorimi i klientëve, ndërprerja e shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesat bankare apo pagesa on- linë; Të hartojë një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri; Të monitorohet konsumi i energjisë dhe të menaxhohet për të fituar kontrollin mbi këto kosto, duke zbatuar një sistem për menaxhimin e energjisë, e cila për shoqërinë do të ishte një mënyrë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjatë për energjinë, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të reduktojë humbjet e ujit, për çdo m³ ujë të humbur që është pompuar dhe ka shkaktuar konsum të energjisë si një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e konsumit të energjisë,
- Të hartojë një data basë me të gjithë konsumin e energjisë(bazuar tek matësit, faturat e energjisë etj.) duke përfshirë të gjitha elementet e energjisë dhe sasitë korresponduese të konsumit dhe kostos,
- Të krahasoj dhe kontrollojë konsumin mujor të energjisë me muajin paraardhës, me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe të shpjegojë nëse është më shumë dhe pse ka ardhur ky ndryshim,
- Të realizojë trajnime për efikasitetin e energjisë për stafin operativ,

11. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura” ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjiellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr.539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjiellës kanalizime” ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.

Vlerësimi i konkurrencës

12. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.
13. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:
- a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjetës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
 - e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
14. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjetës Kanalizimeve.
15. Me vendimin nr. 657, Datë 21.11.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetës Kanalizime Vlorë” SHA, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:
1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetës Kanalizime Vlorë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në

parimin e mosdiskriminimit.

2. ERRU të kërkoj nga Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.

3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

16. Nga analiza e konkurrencës rezulton se Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si institucion rregullator/ autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit të UK Vlorë SHA drejt kostos.

17. Në aplikimin për nivel të ri të tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifën variabël dhe fikse të FU dhe KUN për UK Vlorë, por jo në nivelet që propozon Ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr.539, datë 30.12.2021” Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetllës kanalizime” duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifën (kostot operacionale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2022) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.

18. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKKR nr.539/2021 përmban dhe aprovimin e prezantimit për në Seancën Dëgjimore me Publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të web-it të Bashkisë Vlorë si edhe të UK Vlorë SHA, konstatojmë se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike.

19. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).

20. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. T'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë, UK Vlorë SHA seancat e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 1043, Datë 29. 12 .2023

“MBI MIRATIMIN E “MANUALIT TË PROCEDURAVE PËR SJELLJET ANTIKONKURREUESE””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e “Manualit të Procedurave për Sjelljet Antikonkurreuese”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft-Manualit të Procedurave për Sjelljet Antikonkurreuese.

VËREN SE :

1. Manuali i propozuar është përshtatur duke u përafuar me “Manualin e procedurave për sjelljet antikonkurreuese - Dokument i brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës të Komisionit Evropian mbi procedurat për zbatimin e neneve 101 dhe 102 TFEU”⁴.
2. Qëllimi i këtij Manuali është të ofrojë udhëzime praktike për stafin e Autoritetit të Konkurrencës lidhur me kryerjen e procedurave hetimore në zbatim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Dokumenti synon të rrisë transparencën dhe parashikueshmërinë e procesit brenda kuadrit ekzistues ligjor dhe procedural, duke përmirësuar kështu efektivitetin e hetimeve për antitrust.
3. Manuali është hartuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” lidhur me procedurat për marrëveshjet e ndaluara dhe për abuzimin e pozitës dominuese, si dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
4. Në çdo rast, Manuali nuk përmban udhëzime të detyrueshme për stafin e Autoritetit, dhe procedurat e parashikuara në të mund të jenë të nevojshme të përshtaten me rrethanat specifike të çështjes në shqyrtim.
5. Temat kryesore të trajtuara në të përfshijnë nisjen e procedurave hetimore, hetimet e përgjithshme, procedurat e vendimmarjes, trajtimin e ankesave, inspektimet në ndërmarrje dhe kontrollin në mjedise të tjera, të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, ruajtjen e konfidencialitetit dhe sekreteve tregtare, aksesin në dosje, vendimet me angazhime, masat e përkohshme, lehtësimin nga gjobat, gjobat periodike, udhëzimet joformale, mbylljen administrative të dosjes së hetimit, etj.

⁴ European Commission, Directorate-General for Competition, Antitrust manual of procedures – Internal DG Competition working documents on procedures for the application of Articles 101 and 102 TFEU, Publications Office, 2019

6. Udhëzimet e parashikuara në Manual janë të orientuara drejt nevojave praktike të punës së stafit të Autoritetit të Konkurrencës. Megjithatë, ato nuk pretendohen të jetë të plota ose shteruese, si dhe të trajtojnë çdo pyetje që mund të lindë përgjatë një procedure hetimore, në një mënyrë të detajuar.
7. Si një mjet praktik pune, Manuali mund të evoluojë nëpërmjet përditësimeve me qëllim për të reflektuar ndryshimet e bëra në kuadrin ligjor të konkurrencës dhe eksperiencën e re të fituar në zbatimin e tyre.
8. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet dispozitave të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dhe parashikimeve të Manualit të Procedurave për Sjelljet Antikonkurrese, do të zbatohet gjithmonë kuadri ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Miratimin e “Manualit të Procedurave për Sjelljet Antikonkurrese”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1044, Datë 29. 12. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË FIER THERMOELECTRIC SHA NGA SHOQËRITË DEPA COMMERCIAL S.A., GEK TERNA S.A. DHE GENER 2 SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 12. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve”, nënshkruar më datë 17 nëntor 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DEPA Commercial S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar në Greqi, e angazhuar në furnizimin, tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë të gazit natyror, si dhe furnizimin me pakicë të energjisë elektrike.

DEPA Commercial S.A. zotërohet nga Fondi i Zhvillimit të Pasurive të Republikës Helenike dhe nga

Helleniq Energy Holdings.

DEPA Commercial S.A. ka importuar dhe eksportuar energji elektrike në dhe nga Shqipëria.

Pala shitëse: Gek Terna Societe Anonime Holdings, Real Estate, Constructions (GEK TERNA S.A.) është një shoqëri anonime, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Greqisë, aktive në fushën e ndërtimit, infrastrukturës, energjisë së rinovueshme, prodhimit termik të energjisë, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, koncesioneve, menaxhimit të mbetjeve, minierave dhe zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme.

Shoqëria Target: FIER Thermoelectric SHA është zotëruesi, mbajtësi i licencës, zhvilluesi dhe operatori i një termocentrali për prodhimin e energjisë me turbina me cikël të kombinuar prej rreth 170MW në Roskovec, pranë Fierit, Shqipëri që do të lidhet me sistemin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline AG.

FIER Thermoelectric është një shoqëri e themeluar së fundmi dhe nuk ka realizuar xhiro në tregun shqiptar.

Aktualisht, FIER Thermoelectric SHA zotërohet nga GEK TERNA S.A. dhe nga GENER 2 SHPK.

GENER 2 SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e angazhuar në sektorë të ndryshëm, përfshirë ndërtimin, infrastrukturën, punët civile, energjinë, zhvillimin e pasurive të paluajtshme, telekomunikacionet, tregtinë me pakicë dhe koncesionet, i pranishëm në tregun shqiptar dhe në rajonin më të gjerë. GENER 2 SHPK aktualisht zotërohet nga z. Bashkim Ulaj, z. Ahmet Ulaj dhe z. Astrit Ulaj.

GENER 2 zotëron 100% shoqërinë Dragobia Energy SHPK, i cili nëpërmjet HEC Dragobia & Ceremi e lidhur në sistemin e transmetimit, prodhon energji elektrike.

II. Përqendrimi

Më datë 17 nëntor 2023, ndërmjet shoqërive DEPA Commercial S.A. (blerësi) dhe GEK TERNA S.A. (shitësi) është nënshkruar “Marrëveshje për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve” për shitjen dhe blerjen e 35% të kapitalit aksionar në FIER Thermoelectric SHA. Në të njëjtën datë, shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A., GENER 2 SHPK dhe Fier Thermoelectric SHA kanë nënshkruar Marrëveshjen e Aksionarëve.

Referuar Marrëveshjes për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve, shitësi zotëron 70% të totalit të kapitalit aksionar të shoqërisë target dhe të të drejtave të votës. Blerësi ka rënë dakord të blejë nga shitësi 35% të totalit të kapitalit aksionar të emtuar të shoqërisë target dhe të të drejtave të votimit.

Referuar Marrëveshjes së Aksionarëve, Bordi Mbikqyrës do të përbëhet nga 6 anëtarë, 2 nga DEPA Commercial S.A., 2 nga GEK TERNA S.A. dhe 2 nga GENER 2 SHPK. Kryetari i Bordit do të jetë nga Depa Commercial S.A. dhe nënkryetari do të jetë nga Gener 2 SHPK. Kryetari dhe Zevendëskryetari nuk kanë një votë vendimtare. Vendimet e Bordit miratohen në një asamble ku janë të pranishëm më shumë se 50% e drejtorëve, përveç çështjeve të rezervuara të Bordit (ku përfshihet miratimi i planit të biznesit etj) për të cilat kërkohet miratimi në mënyrë unanime.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme miratohen me 60% të votave, por vendimet për çështjet e rezervuara të aksionarëve (ku përfshihet miratimi dhe ndryshimi i buxhetit, miratimi i investimeve, miratimi dhe çdo ndryshim në Modelin Financiar etj) do të miratohen në mënyrë unanime.

Më datë 17 nëntor 2023, transaksioni i propozuar është njoftuar në Komisionin Europian dhe më datë 11.12.2023, Komisioni ka vendosur të mos kundërshtojë operacionin e njoftuar dhe ta deklarojë atë në përputhje me tregun e brendshëm dhe me Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Europiane.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target FIER Thermoelectric SHA do të zotërohet 35% nga

DEPA Commercial S.A., 35% nga GEK TERNA S.A. dhe 30% nga GENER 2 SHPK.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e Përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, në pikën 78 citohet se: **“Hyrja e aksionarëve të rinj në një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht ose duke shtuar numrin e aksionarëve tashmë kontrollues ose duke zëvendësuar një nga ata, gjithashtu përbën një përqendrim që duhet njoftuar, pavarësisht se ndërmarrja kontrollohet bashkërisht para dhe pas operacionit.**

Në transaksionin e mësipërm, në strukturën e shoqërisë target hyn një aksionar i ri kontrollues, DEPA Commercial S.A. Duke qënë se secili aksionar së vetmi ka të drejta bllokuese në lidhje me vendime strategjike, aksionarët kontrollues të përbashkët duhet të marrin në konsideratë interesat e njëri-tjetrit dhe të bashkëpunojnë për përcaktimin e sjelljeve strategjike të sipërmarrjes së përbashkët.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit me shumicë të energjisë elektrike.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i energjisë elektrike rregullohet më Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përmban rregulla të përgjithshme për furnizimin e energjisë elektrike për konsumatorët, përmes krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë. Sistemi elektroenergjitik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: Prodhimi, Transmetimi, Shpërndarja e energjisë elektrike, si dhe Tregtimi me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike.

Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH SHA dhe shoqëria HEC Lanabregas SHA të cilat janë shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, si dhe nga subjektet private të licencuara në këtë aktivitet të tilla si: prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike. Prodhuesit me përparësi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike janë subjekte të licencuara në vite nga ERE që shfrytëzojnë centrale ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të privatizimit, marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike.

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2022, pavarësisht mënyrës së funksionimit të prodhuesit, është 7,002,645 MWh.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2022, nga KESH sh.a. zë 55.11% të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 44.89%.

Referuar Raportit vjetor të ERE, kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrethin e transmetimit gjatë vitit 2022 është rreth 2,266 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 6,149,229 MWh. Shoqëria Dragobia Energy SHPK, nëpërmjet HEC Dragobia & Ceremi e lidhur në sistemin e transmetimit, prodhon energji në vlerën 68,542 MWh duke zënë 1.1% të prodhimit total.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrethin e shpërndarjes përgjatë vitit 2022 është rreth 348 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 853,414 MWh.

Aktualisht, nuk po prodhohet energji nga termocentrale në Shqipëri (të cilat përfshijnë gaz natyror).

Ekziston vetëm një central elektrik, TEC Vlora, i cili nuk ka qenë operativ që nga viti 2012. TEC Roskovec CCPP (180 MW) – FIER THERMOELECTRIC SHA (targeti) është një central i cili ka marrë opinion paraprak për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2022, por ende nuk ka filluar prodhimin.

Transmetimi i energjisë elektrike

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) SHA, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore. Transmetimi i Energjisë Elektrike në Shqipëri kryhet nëpërmjet sistemit të transmetimit i cili përfshin rrjetin me tensioni të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV.

OST SHA zhvillon Sistemin e Transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje.

Prodhimi neto vendas për vitin 2022 rezulton të jetë 7,002 GWh, ndërkohë që konsumi total i vendit rezulton të jetë 7,924 GWh, me një balancë neto në drejtimin import 921 GWh.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për vitin 2022 prej 921 GWh, rezulton si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 2,123 GWh dhe importit të realizuar në vlerën 3,044 GWh. Kjo diferencë është e kuptueshme për faktin se sistemi elektroenergjitik shqiptar e bazon prodhimin e energjisë elektrike në burimet hidrike, ku për periudhat me reshje arrin të eksportojë energji elektrike dhe në periudhat e thata gjatë vitit realizon import të energjisë elektrike për të mbuluar kërkesën në vend.

Gjatë vitit 2022, janë planifikuar kapacitete shtesë prodhuese të cilat janë në fazën e propozimit apo në fazë ndërtimi dhe që priten të energjizohen gjatë vitit 2022-2023.

Referuar të dhënave të depozituara nga pala njoftuese, shoqëria DEPA Commercial S.A. ka importuar dhe eksportuar energji elektrike në dhe nga Shqipëria. Vëllimi total i eksporteve të elektricitetit të DEPA-s drejt Shqipërisë është minimal krahasuar me vëllimin total të eksporteve të elektricitetit të bëra në vend nga eksportues të tjerë, siç tregohet nga Raporti i Bilancit të Energjisë për vitin 2022, ku Shqipëria ka importuar një total prej 3,043,533 MWh energji. Këto të dhëna dëshmojnë se pjesëmarrja e DEPA-s në tregun shqiptar të furnizimit me energji elektrike mbetet e kufizuar. Edhe pjesëmarrja e GEK TERNA në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri për furnizim mbetet e kufizuar.

Si rrjedhojë, transaksioni i njoftuar nuk do të ndikojë konkurrencën në Shqipëri.

Lidhur me furnizimin me pakicë të energjisë elektrike, aktivitetet e Grupit GEK TERNA dhe DEPA, janë kryesisht të përqendruara në Greqi.

FIER Thermoelectric SHA do të shesë, drejtpërdrejtë apo indirekt, energjinë e prodhuar nga impianti i saj në tregun shqiptar të energjisë elektrike, por në këtë fazë nuk është planifikuar asnjë aktivitet për furnizimin me pakicë nga TEC FIER.

Shpërndarja e energjisë elektrike

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) SHA, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore dhe është licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike. OSSH SHA prokuron energji elektrike në tregun e hapur dhe nga burimet e rinovueshme, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Tregu i gazit natyror

Gazi natyror vjen nga fushat e naftës ose nga fushat e gazit natyror. Pas përpunimit dhe pastrimit në një impiant trajtimi, ai mund të furnizohet ose në formë gazore përmes tubacioneve, ose në formë të

lëngët si LNG.

Tregu për furnizimin me pakicë i gazit natyror në Shqipëri nuk ekziston dhe DEPA do të jetë një nga furnizuesit e parë që do të hyjnë në këtë treg përmes pikës së hyrjes greke nga Tubacioni Trans Adriatik (TAP).

Për sa i përket furnizimit me pakicë të gazit natyror, aktivitetet e GEK TERNA dhe DEPA janë të përqendruara kryesisht në Greqi.

Në përfundim të analizës konstatohet se transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK.

DEPA Commercial S.A. është një shoqëri aktive në furnizimin, tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë të gazit natyror, si dhe furnizimin me pakicë të energjisë elektrike në shtetin grek.

DEPA Commercial S.A. ka importuar dhe eksportuar energji elektrike në dhe nga Shqipëria, por pjesëmarrja e saj në tregun shqiptar të furnizimit me energji elektrike mbetet e kufizuar. Vëllimi total i eksporteve të elektricitetit të DEPA-s drejt Shqipërisë është vetëm minimal krahasuar me vëllimin total të eksporteve të elektricitetit të bëra në vend nga eksportues të tjerë.

GEK TERNA S.A. është një shoqëri aktive në fushat e ndërtimit, infrastrukturës, prodhimit të energjisë, furnizimit dhe tregtisë së energjisë së pastër nga burimet termike dhe të rinovueshme, furnizimit dhe tregtisë së energjisë elektrike dhe gazit natyror, koncesioneve etj.

Pjesëmarrja e GEK TERNA në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri për furnizim mbetet e kufizuar krahasuar me vëllimin total të eksporteve të bëra në vend nga eksportues të tjerë.

GENER 2 është një shoqëri aktive kryesisht në fushën e ndërtimit, me një portofol të projekteve të ndërtimit të banesave dhe ndërtesave tregtare, rrugëve, autostradave dhe projekteve të infrastrukturës. Nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej saj, Dragobia Energy SHPK, GENER 2 realizon të ardhura në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Dragobia & Ceremi, e lidhur në sistemin e transmetimit, duke prodhuar energji në vlerën 68,542 MWh për vitin 2022 dhe duke zënë 1.1% të prodhimit total të energjisë elektrike në vend.

FIER Thermoelectric SHA është zotëruesi, mbajtësi i licencës, zhvilluesi dhe operatori i një termocentrali, dhe në veçanti i një turbine me gaz me cikël të kombinuar, në Roskovec, Fier. FIER Thermoelectric SHA është një shoqëri e themeluar së fundmi dhe nuk ka realizuar xhiro në tregun shqiptar.

Për sa i përket furnizimit me pakicë të gazit natyror, aktivitetet e GEK TERNA dhe DEPA janë të përqendruara kryesisht në Greqi. Tregu për furnizimin me pakicë i gazit natyror në Shqipëri nuk ekziston dhe DEPA do të jetë një nga furnizuesit e parë që do të hyjnë në këtë treg përmes pikës së hyrjes greke nga Tubacioni Trans Adriatik (TAP).

Qëllimi i krijimit të termocentralit, përmes target, është mbulimi i mungesës së energjisë elektrike të Shqipërisë nga asetet e prodhimit të energjisë vendase dhe përmirësimi i kontrollit të frekuencës së sistemit shqiptar. Si fillim, shoqëria target do të plotësojë nevojat vendase dhe në një fazë të dytë do të vlerësojë eksportet në vendet fqinje jo të Komunitetit Evropian.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim aktualisht në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë

28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë FIER Thermoelectric SHA nga shoqëritë DEPA Commercial S.A., GEK TERNA S.A. dhe GENER 2 SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1045, Datë 29. 12. 2023

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djath dhe gjalpë)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29. 12. 2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit; dhe;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit paraprak,
- Takimit të realizuar me përfaqësues të MBZHR dhe AKU në datën 12.12.2023
- Informacion shtesë mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit.

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të qumështit, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.
2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të këtij monitorimi, me Vendimin nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit, për periudhën kohore nga 1 Janar 2022 deri në 31 Mars 2023, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 99/5, datë 28.02.2023, "Autorizim inspektorësh", inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë periudhës së hetimit paraprak, kryen inspektime pranë ndërmarrjeve nën hetim që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit.
4. Për shkak të numrit të lartë të inspektimeve pranë ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, shtrirjes gjeografike të vendndodhjes së tyre, sasisë së të dhënave për përpunim, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 980/2023 vendosi të shtyjë me 3 (tre) muaj, paraqitjen e raportit të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit.
5. Në vazhdim të procedurës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Instituti i Statistikave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
6. Gjithashtu në datën 12.12.2023, Komisioni i Konkurrencës realizoi një takim me përfaqësues të MBZHR dhe AKU për të qartësuar disa problematika në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit.

II. KUADRI LIGJOR DHE FUNKSIONIMI I TREGUT

7. Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi rregullohen nga ligji nr. 9441, datë 11.11.2005, "Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi", si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
8. Referuar ligjit nr. 9441/2005, veprimtaria e prodhimit, grumbullimit, standardizimit, përpunimit dhe tregtimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi, përfshihet në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat, duke u pajisur me licencë "Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve". Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Kriteret e licencimit përcaktohen në VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulime të tjera nënligjore të përbashkëta".
9. Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 9441/2005, pranë Ministrisë së Bujqësisë ngrihet Këshilli i Ekspertëve të Qumështit, organizimi, funksionimi, struktura dhe detyrat e të cilit përcaktohen me VKM nr. 580, datë 23.8.2006, "Për organizimin, funksionimin, strukturën dhe detyrat e Këshillit të Ekspertëve të Qumështit". Ndër detyrat kryesore të Këshillit të Ekspertëve të Qumështit janë: a) dhënie mendimi për politikat që rregullojnë fushën e prodhimit, të përpunimit dhe kontrollit të qumështit e të produkteve me bazë qumështi; b) dhënie mendimi për programet afatgjata të zhvillimit të kësaj fushe; c) dhënie mendimi për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet hallkave kryesore të prodhimit, përpunimit, tregtimit dhe kontrollit, të parashikuara në ligj, si dhe ndërmjet strukturave të pushtetit, qendror e vendor; ç) Sugjeron hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore, të urdhëresave dhe rregulloreve, që dalin në zbatim të ligjit nr. 9441, datë 11.11.2005 dhe i shqyrton ato para dërgimit për miratim në organet përkatëse; etj.

10. Në zbatim të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave ka miratuar Udhëzimin nr. 19, datë 03.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i cili ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat mbi zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë/fermerëve. Sipas këtij udhëzimi, ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit e realizojnë blerjen e lëndës së parë (qumësht) vetëm nga fermerë të pajisur me NUIS (numër unik i identifikimit të subjektit), sipas “Akt-marrëveshjes “TIP” të lidhur me këta fermerë.
11. Nga vlerësimi i akteve ligjore, mund të themi se nuk ekzistojnë barrierat ligjore për hyrjen në këtë treg të ndërmarrjeve të reja, por ka barrierat ekonomike për shkak se investimet fillestare janë të larta, pasi makineritë dhe pajisjet e tjera prodhuese kanë kosto të lartë. Megjithatë çdo ndërmarrje që ka mundësitë ekonomike është e lirë të hyjë në treg.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III. 1 Tregu përkatës

12. Përcaktimi i tregut përkatës është elementi kryesor i analizës së konkurrencës. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, *“tregu përkatës përbëhet nga produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”*. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
13. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”, gjatë hetimit janë marrë në analizë nënproduktet e qumështit djathë dhe gjalpë.
14. Për sa më sipër, kemi të bëjmë me dy nënprodukte të ndryshme të qumështit, djathë dhe gjalpë, prandaj kemi dy tregje përkatëse produkti, të cilat ndahen në nën tregje sipas llojit të qumështit të përdorur për prodhimin e tyre.
15. Nga analiza e të dhënave të ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje rezulton se produktet djathë kaçkavall dhie, gjalpë dele dhe gjalpë dhie, prodhohen vetëm nga një numër i vogël ndërmarrjesh dhe sasia e prodhuar dhe e shitur e këtyre produkteve është shumë e vogël, për këtë arsye këto produkte janë përjashtuar nga analiza.
16. Tregu përkatës në këtë rast është konsideruar: Tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit, djathë dhe gjalpë, i ndarë në nën tregje:
- Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të djathit të bardhë nga qumështi i lopës;
 - Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të djathit të bardhë nga qumështi i deles;
 - Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të djathit të bardhë nga qumështi i dhisë;
 - Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të djathit kaçkavall nga qumështi i lopës;
 - Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të djathit kaçkavall nga qumështi i deles;
 - Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të gjalpë nga qumështi i lopës;

në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III.2 Struktura e tregut dhe sjellja e ndërmarrjeve në treg

17. Nga analiza e të dhënave të administruara nga ndërmarrjet gjatë procedurës hetimore, rreth volumit të prodhimit, volumit të shitjeve dhe çmimeve mesatare mujore të shitjes për produktet djathë i bardhë i lopës, djathë i bardhë i deles, djathë i bardhë i dhisë, djathë kaçkavall i lopës, djathë kaçkavall i deles, gjalpë i lopës, sipas ndërmarrjeve prodhuese të këtyre produkteve për vitin 2022, si dhe periudhën janar-mars 2023, rezulton si më poshtë vijon:
18. Nën tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të djathit të bardhë nga qumështi i lopës zë rreth X% të sasisë totale të shitur të produktit djathë. Nga ndërmarrjet e analizuar në këtë raport, ndërmarrjet Erzeni SHPK, ADG SHPK(Lufra) dhe Mireli SHPK zënë pjesën më të madhe të shitjeve të produktit djathë i bardhë nga qumështi i lopës, me rreth X% së bashku. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë shumë të vogël në treg, prandaj dhe tregu është shumë i përqendruar, me indeksin e përqendrimit HHI mbi XXX.
19. Nën tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të djathit të bardhë nga qumështi i deles zë rreth X % të sasisë totale të shitur të produktit djathë. Nga ndërmarrjet e analizuar në këtë raport, Gjiofarma SHA, Erzeni SHPK dhe SHAKA Boboshtice SHPK zënë pjesën më të madhe të shitjeve të produktit djathë i bardhë nga qumështi i deles, me rreth X% së bashku, ku ndërmarrja Gjiofarma SHA zë rreth X% të tregut për vitin 2022. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë shumë të vogël në treg, prandaj dhe tregu është shumë i përqendruar, me indeksin e përqendrimit HHI mbi XXX.
20. Nën tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të djathit të bardhë nga qumështi i dhisë zë rreth X% të sasisë totale të shitur të produktit djathë. Nga ndërmarrjet e analizuar në këtë raport, SHAKA Boboshticë SHPK, Erzeni SHPK dhe Gjiofarma SHA zënë pjesën më të madhe të shitjeve të produktit djathë i bardhë nga qumështi i dhisë, me rreth X% së bashku. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë shumë të vogël në treg, prandaj dhe tregu është shumë i përqendruar, me indeksin e përqendrimit HHI mbi XXX.
21. Nën tregu i prodhimit, dhe tregtimit me shumicë të djathit kaçkavall nga qumështi i lopës zë rreth X% të sasisë totale të shitur të produktit djathë. Nga ndërmarrjet e analizuar në këtë raport, Mireli SHPK, Erzeni SHPK dhe ADG SHPK (Lufra), zënë pjesën më të madhe të shitjeve të produktit djathë kaçkavall nga qumështi i lopës, me rreth X% së bashku. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë shumë të vogël në treg, prandaj dhe tregu është me një përqendrim në nivelin mesatar, me indeksin e përqendrimit HHI nën XXX.
22. Nën tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të djathit kaçkavall nga qumështi i deles zë rreth X% të sasisë totale të shitur të produktit djathë. Nga ndërmarrjet e analizuar në këtë raport, Erzeni SHPK, SHAKA Boboshticë SHPK, dhe ORHAN SHPK zënë pjesën më të madhe të shitjeve të produktit djathë kaçkavall nga qumështi i deles, me rreth X% së bashku, ku Erzeni SHPK zë X% të këtij tregu për vitin 2022. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë shumë të vogël në treg, prandaj dhe tregu paraqitet me një nivel shumë të lartë përqendrimi, me indeksin e përqendrimit HHI mbi XXX.
23. Nën tregu i prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gjalpë nga qumështi i lopës zë rreth X % të sasisë totale të shitur të produktit gjalpë. Nga ndërmarrjet e analizuar në këtë raport, Erzeni SHPK, ADG SHPK (Lufra) dhe Mireli SHPK zënë pjesën më të madhe të shitjeve të produktit

- gjarpë nga qumështi i lopës, me rreth X%, ku Erzeni zë rreth X% të tregut për vitin 2022. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë shumë të vogël në treg, prandaj dhe tregu është shumë i përqendruar, me indeksin e përqendrimit HHI mbi XXX.
24. Duke marrë parasysh kriteret e vlerësimit të pozitës dominuese, si: pjesën e tregut të ndërmarrjeve, barrierat për hyrjen në treg, konkurrencën potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, rezulton se vetëm sipas pjesëve të tregut në nëntregje të nënprodukteve të qumështit ka ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme tregu si Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHA, SHAKA Boboshticë SHPK.
25. Sipas informacioneve të administruara gjatë inspektimeve në ndërmarrjet e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit ka rezultuar se çmimi i qumështit dhe për rrjedhojë edhe i nënprodukteve të tij ka pësuar rritje kryesisht gjatë vitit 2022. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të shitjes me shumicë të nënprodukteve nga qumështi i lopës, konstatohet se çmimet e shitjes së nënprodukteve të qumështit të aplikuara nga ndërmarrjet nuk ndjekin rritimin e rritjes së cmimit të qumështit të lopës.
26. Evidencat e grumbulluara gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të produkteve djathë i bardhë lope, djathë i bardhë dele, djathë i bardhë dhie, djathë kaçkavall lope, djathë kaçkavall dele dhe gjalpë lope, nuk përmbajnë shenja të një marrëveshje ose sjellje të bashkërenduar midis ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, por referuar analizës së tregut të e prodhimit dhe shitjes me shumicë të nënprodukteve të qumështit, rezulton se sjellja e ndërmarrjeve me pjesë të konsiderueshme tregu Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK, mund të përbëjë abuzim me pozitë dominuese sipas nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja d), nenin 26, dhe nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK, në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit.
- II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022- 31 dhjetor 2023.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

2023

VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS

2023

BULETINI ZYRTAR



AUTORITETI I
KONKURRENCËS